

FAKULTETI I ARKITEKTURËS
PROGRAMI STUDIMOR
BSc NË ARKITEKTURË

Viti I

Semestri I			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
I-1	O	Bazat e Projektimit 1	2	2	6
I-2	O	Konstruksionet Arkitektonike 1	2	2	6
I-3	O	Arkitektura dhe Gjeometria	2	1	4
I-4	O	Vizatim i Lirë dhe Estetika e Hapësirës	2	1	4
I-5	O	Matematikë	2	1	4
I-6	O	Historia e Artit	2	0	3
I-7	O	Gjuha Angleze	2	0	3
					30

Semestri II			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
II-1	O	Bazat e Projektimit 2	2	2	6
II-2	O	Konstruksione Arkitektonike 2	2	2	6
II-3	O	Reprezentimi Arkitektonik	2	1	4
II-4	O	Materialet e Ndërtimit në Arkitekturë	2	1	4
II-5	O	Historia e Arkitekturës – Antika	2	1	4
II-6	O	Kompozicioni dhe Analiza Arkitektonike	2	0	3
II-7	O	Arkitektura Digjitale dhe Modelimi	1	1	3
					30

Viti II

Semestri III			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
III-1	O	Projektim 1 – Banim Individual	2	2	6
III-2	O	Konstruksionet Arkitektonike 3	2	2	6
III-3	O	Teoria e Strukturave	2	1	4
III-4	O	Sistemet Bashkëkohore të Ndertesave 1	2	1	4
III-5	O	Historia e Arkitekturës – Mesjeta	2	1	4
III-6	O	CAD	1	1	3
III-7	Z	Hyrje në Projektimin e Objekteve Publike	2	0	3
III-8	Z	Qyteti dhe Shoqëria	2	0	3
III-9	Z	Topografi	1	1	3
					30

Semestri IV			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
IV-1	O	Projektim 2 – Objektet shumëbanesore	2	2	6
IV-2	O	Konstruksionet Arkitektonike 4	2	2	6
IV-3	O	Historia e Arkitekturës – Koha e Re	2	1	4
IV-4	O	Hyrje në Urbanizëm	2	2	6
IV-5	O	Sistemet Bashkëkohore të Ndertesave 2	2	1	4
IV-6	Z	Projektim - Komplekset e Parkimit Stacionar	2	1	4

IV-7	Z	Teknikat e Urbanizmit	2	1	4
IV-8	Z	Shkencat Humane dhe Arkitektura	2	1	4
					30

Viti III

Semestri V			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
V-1	O	Projektim 3 – Banimi i përkohshëm	2	2	6
V-2	O	Projektim 4 – Ndërtesat Komeriale dhe Tregtare	2	2	6
V-3	O	Urbanizmi 1	2	1	4
V-4	O	Arkitektura Moderne dhe Trendet Bashkëkohore	2	0	3
V-5	O	Fizika e ndërtimit	1	1	3
V-6	Z-Q	Struktura Hapësinore	2	1	4
V-7	Z-Q	Ndërtimi Montazh	2	1	4
V-8	Z-U	Sociologjia Urbane	2	1	4
V-9	Z-U	Arkitektura e peizazhit	2	1	4
V-10	Z-P	Projektim – Qendrat e Komunitetit	2	1	4
V-11	Z-P	Projektim – Data Qendrat dhe Termialet Distribuive	2	1	4
V-12	Z-T	Fenomenologjia dhe Arkitektura	2	1	4
V-13	Z-T	Regjionalizmi në Arkitekturë	2	1	4
V-14	Z-A	Arti, Kultura dhe Teknologjia	2	1	4
V-15	Z-A	Hapësira, Fuqia dhe Reprerentimi	2	1	4
					30

Semestri VI			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
VI-1	O	Projektim 5 – Komplekset Industriale	2	2	6
VI-2	O	Projektim 6 – Objektet Administrative-Afariste	2	2	6
VI-3	O	Urbanizmi 2	2	1	4
VI-4	O	Strukturat Inxhinierike	2	1	4
VI-5	O	Teoria dhe Kriticizmi në Arkitekturë	2	1	4
VI-6	Z	Punim diplome (BSc)**	/	/	6
					30

Vërejtje:

- (U*) janë ushtrime praktike apo laboratorike të cilat organizohen në grupe sipas Statutit dhe Rregulloreve në fuqi të UP-s (ref: Rregullore 2/486 të datës 11/09/2019, Neni 16 – pika 2, tabela Nr.7 dhe Neni 17 – pika 2, tabela Nr.10)

Përshkrimet e shkurta të lëndëve në programin e studimeve BScA

Titulli i lëndës:	BAZAT E PROJEKTIMIT 1
Mesimdhënesi:	Dr.sc. Rozafa Basha
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Ky kurs synon t'i njoftojë studentët e arkitekturës me përkufizimet themelore të formës dhe hapësirës dhe parimeve që do t'i ndihmojnë për të vënë rend në ambientin e ndërtuar. Në këtë kurs forma dhe hapësira nuk prezantohen si caqe por si mjete për të zgjidhur problemet, që kanë të bëjnë me konditat e funksionit, qëllimit, dhe kontekstit.
Qëllimet e lëndës:	Kursi ka për qëllim t'iu paraqes studentëve një definicion të thjeshtësuar të arkitekturës, duke madhështuar aspektin vizual të balansit arkitektonik, dhe për t'i njoftuar studentët me të gjitha parimet vizuale të dizajnit duke përdorur dorën si mënyrë të vetme të prezantimit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Të krijojë kompozicione harmonike arkitektonike përmes zbatimit të ligjshmërive dhe karakteristikat pamore të formave dhe hapësirës. - Të zbatojë ligjshmëritë e teorive të harmonisë së ngjyrave në kompozicione arkitektonike; - Të përdorë ligjshmëritë e proporcioneve dhe të masës si mjete të shprehurit arkitektonik - Të shqyrtojë dhe analizojë komponentët arkitektural në vepra arkitekturale të tjera si parakusht për nisjen e veprimtarisë vetanake. - Të përkufizojë atributet themelore të formës dhe hapësirës dhe të parimeve që do t'i ndihmojnë për të vënë rend në mjedisin e ndërtuar.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërimit ex-catedra si dhe diskutimi i temave që ndërlidhen me ligjëratat në mënyrë interaktive me studentët. Ushtrimet zhvillohen përmes detyrave tematike grafike javore që punohen dhe diskutohen në klasë, si dhe detyrave grafike shtëpiake. Detyrat grafike do të jenë: individuale dhe grupore.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi nga prezenca - 5%; Punimet individuale grafike - 40%; Punimi/et grupor/e grafik/e - 20%; Kolokuimi 1 dhe 2 - 30%; Seminar i shkurtër - 5%. Provimi me shkrim mbahet për studentët që nuk i kalojnë kolokuimet.
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. R. Basha; ligjërata të autorizuara, FA, UP, Prishtinë. 2. F. D. K. Ching, 'Architecture, Form, Space and Order'— John Wiley&Sons, 2014; 3. S. E. Rasmussen, 'Experiencing Architecture' - MIT Press, 1964 4. J. Itten, The Elements of Color, Van Nostrand Reinhold Company, 1970 4. J. Albers, Interaction of Color, Yale University Press, 2013
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. S. Unwin, 'Exercises in Architecture – Learning to Think as an Architect', Routledge, 2012 2. R. McCarter, J. Pallasmaa, 'Understanding Architecture', Phaidon Press, 2012 3. S. Holl, J. Pallasmaa, A. Perez-Gomez: 'Questions of perception – phenomenology of architecture', — William Stout San Francisco 2006

	4. J. Pallasma. ‘The Eyes of the Skin: Architecture and the Senses’, John Wiley & Sons; 2nd edition, 2005 5. S.Unwin, Analysing Architecture, Routledge, 2014
--	--

Titulli i lëndës:	KONSTRUKSIONET ARKITEKTONIKE 1
Mesimdhësi:	Xhelal Lloncari, IDA
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6

Përshkrimi i lëndës:	Lënda përmban 15 ligjerta mbi konceptin e konstrukcioneve, elementeve konstruktive bazë. Lidhja e elementeve konstruktive në mes vedi si dhe sajimi i strukturave në tërësi dhe sisteme të veçanta të ndërtimit. Muraturat me lemente të ndryshme për muratim, elementet e mureve si hapjet dhe kanalet brënda ture siq janë oxhaqet dhe kanalet për ajrosje. Njoftimi me modilin elementar, projektues dhe atë konstruktiv.
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me konceptin e konstrukcioneve, paisja me njohuri mbi elementet konstruktive lidhjen e tyre në mes vedi në sisteme të ndërtimit në shtrojen e modularitetit aftësimi i tyre në prezantimin grafik të konstrukcioneve në planimetri, preje dhe aksonometri me kotat dhe masat enevojshme për transmetim të objektit në terren.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Nga studentët pritet të jenë të aftë ti dallojnë elemente konstruktive dhe karakteristikat e tyre, të kuptojnë dhe sajimin e sisteme të ndërtimit. Të jenë të aftë të bëjnë prezantimin grafik të objekteve në nivel të projektit kryesor(1:100) si dhe të mendojnë konstruktivisht.
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi është i rregullt me ligjerata grupore që organizohen me metoda audiovizuale. Pjesa tjetër përbehet nga ushtrimet grafike që realizohen me lapsë, bojkinë, fotografi (ose ndonjë teknikë tjetër-nga preferenca e studentit) dhe CAD.
Metodat e vlerësimit:	Punimi Grafik 20%, Vlerësimi i Pare 40 %, Vlerësimi i Dytë 40 %; Studenti i nenshtrohet provimit perfundmatar me shkrim, nese nuk e ka kaluar ndonjeren prej vleresimeve.

Literatura primare:	Ekstrakt i mësimdhënësit për çdo njësi mësimore. “Konstrukcionet arkitektonike”, Ilija Papanikolla,Tirane.; “Bautzachen” H.-J. Dahmlos; “Baukonstruktionslehre 1” (Gebundene Ausgabe), Otto Frick, Karl Knöll, Dietrich Neumann;
Literatura shpërndarë:	Building construction illustrated by D.K. Ching and Cassandra Adams, third edition Baukonstruktionslehre 2 (Gebundene Ausgabe) von Otto Frick (Autor), Karl Knöll (Autor), Dietrich Neumann (Autor)

Titulli i lëndës:	ARKITEKTURA DHE GJEOMETRIA
Mesimdhësi:	Prof.Asoc.Dr. Flamur Doli
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4

Përshkrimi i lëndës:	<p>Ky kurs është një hyrje intensive për disiplinat gjeometrike ne arkitekture që ndikojnë në reciprocitetin midis vizatimit dhe modelimit në procesin e dizajnit arkitekturor, të mësuar kryesisht nëpërmjet një sere ushtrimesh javore ose dy javore. Qëllimi pedagogjik i kursit është dyfishtë, ai teorik dhe grafik. Lënda zhvillohet nëpërmjet mësimeve teorike dhe praktike, përmbajtja e të cilave fillimisht bëhet nga temat e gjeometrisë deskriptive dhe perspektives gjeometrike dhe më pas, pasi fitojnë konceptet kryesore do trajtohen, ne kuader te projekteve arkitektonike.</p> <p>Baza konceptuale e çdo ushtrimi janë parimet gjeometrike që qëndrojnë në thelbin e secilës teknikë, duke 'përgjithësuar' teknikën specifike për të treguar per mundësitë e saj gjeneruese ne kontekste më të gjera.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Pregaditja bazike për prezantimin profesional dhe teknik të formave tredimensionale, përkatësisht projekteve arkitektonike si dhe zhvillimin e aftësive për kuptimin e hapësirës tredimensionale dhe të menduarit hapësinor në kontekst të artikullimit të nocionove themelore në profesionin e arkitekturës. Lënda bënë pjesë në grupin e lëndëve pregaditore dhe mundëson përfitimin e njohurive bazike për studime të mëtejme në lëmin e Arkitekturës dhe të Planifikimit hapësinor.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> -Të sigurojë studentëve përmbajtjen kryesore të gjeometrisë përshkruese dhe zbatimin e saj, në mënyrë që t'i bëjë ata të aftë të përkthejnë modelet gjeometrike të tre dimensioneve të arkitekturës në përfaqësime normativisht korrekte. - të jetë në gjendje të kryejë një lidhje dyanësh mes realitetit dhe modelit të saj të matshëm grafik. Kjo njohuri është thelbësore për të kuptuar hapësirën dhe përfaqësimin e saj në mbështetjen dy dimensionale. Nxënësi gjithashtu do të posedojë njohuritë bazë për të zotëruar të gjitha mjetet e vizatimit. - aplikimi i metodave të ndryshme të përfaqësimit, të bëra nga studimi i gjeometrisë përshkruese dhe praktika e hartimit manual, do t'i lejojë nxënësit të zhvillojë gjuhën e vet grafike dhe shprehjen e tij në fushën specifike të arkitekturës. - zhvillimin e aftësive për kuptimin e hapësirës dy dimensionale dhe tredimensionale dhe të menduarit hapësinor
Metodat e mësimdhënies:	<p>Metoda e të mësuarit të lëndës së Gjeometrisë deskriptive konsiston në mbajtje të ligjeratave dhe mbajtje të ushtrimeve për njësi të veçanta mësimore të përjavshme, pastaj në punimin e grafikoneve dhe modeleve – maketave për njësi të caktuara mësimore.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i pare; Vlerësimi i dytë; Vlerësimi i ushtrimeve; Vlerësimi i maketave; Vijimi i rregullt; Provimi final; Total (përqindja mesatare) 100%.</p>
Literatura primare:	<p>Ligjëratat të përgatitura nga Prof.asoc.dr.Arta Basha-Jakupi The Projective Cast: Architecture and Its Three Geometries. MIT Press, 2000 Ching, F., & Steven P. J., (2010) Design Drawing. 2nd ed. Wiley Cohen, P. S., (2001) Contested Symmetries and Other Predicaments in Architecture. Princeton Architectural Press</p>
Literatura shitesë:	<p>Pottmann, H, Andreas A.,(2007) et al. Architectural Geometry. Bentley Institute Press.</p>

	G.R. Bertoline, E.W. Wiebe, C.L. Miller, L.O. Nasman, (1995) Engineering Graphics Communication. R.D. Irwin Inc., Chicago, Chapter 11, pp. 597–695. Flamur DOLI,1990, Gjeometria Deskriptive
--	---

Titulli i lëndës:	Vizatimi i lirë dhe estetika e hapësirës
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Arta Basha Jakupi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Lënda e Vizatimit të lirë dhe Estetikës së hapësirës i studion format natyrore dhe objektet tri-dimensionale duke u bazuar në studimin e paraqitjes së vizatimit të lirë të vijës, perspektivës, dritës dhe hijes, formës dhe proporcionit. Studentët do ta fitojnë aftësinë që të vizatojnë/paraqesin objektet në mënyra të ndryshme, duke u mundësuar atyre ta vlerësojnë një ndërtesë ose objekt në bazë të elementeve formale - proporcionit, ngjyrës dhe materialeve - dhe mënyrën se si zgjidhja e problemit do të ndikojë në dizajnin e përgjithshëm të hapësirës. Arti i vizatimit është një akt i koordinimitndërmjet dorës, syrit dhe mendjes. Secili prej këtyre elementeve i nënshtrohet praktikës dhe rutinës, prandaj shumë studentë do ta përmirësojnë vizatimin e tyre thjesht duke i mësuar parimet dhe modelet e reja dhe të dobishme.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore i nënshtrohen shqyrtimit të qasjeve të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në vizatim. Theksi do të vihet në zhvillimin e aftësisë së studentit për të parë dhe kuptuar se si të krijojë dhe paraqes hapësirën reale përreth formave të tyre të vërteta, si dhe t'i qaset dhe të zgjedhë teknikën më të përshtatshme për të krijuar një vizatim efektiv. Këto mundësojnë njohjen e studentit për ta kuptuar më lehtë të ashtuquajturën hapësirë arkitekturore.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> - Aplikoj raportin proporcional të vizatimeve duke përdorur matjet. - Demonstroj teknikat themelore të vizatimit të lirë. - Aplikoj parimet e vizatimit perspektiv me një, dy apo tri pika pakufi. - Aplikoj parimet e vizatimit të bazuar në hije, thellësi, teksturë. - Shqyrtoj raportet proporcionale ndërmjet objekteve. - Kombinoj kompozicionin efektiv me zhvillimin e stilit personal. - Definoj dhe artikuloj fjalorin dhe terminologjinë që përdorët në art.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimi duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit 10%; Detyrat individuale të kryera në klasë 30%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 30%; Vlerësimi nga testet ose Provimi final 30%.
Literatura primare:	1.Ligjëratat të përgatitura nga Prof.asoc.dr.Arta Basha-Jakupi 2.Keys to Drawing, Bert Dodson, North Light Books, Cincinnati, Ohio,manufactured in USA, First edition, First paperback printing 1990

Literatura shtesë:	1.White, G., (1989), Perspective-A Guide for Artist, Architects and Designers, BTBatsford Ltd, London Campanario, G., (1990), 2.The Art of Urban Sketching, Quarry Books, Beverly, MA 3.Wnag, Th. C., (2002), Pencil Sketching, 2nd Ed. John Wiley & Sons.Inc, New York
---------------------------	---

Titulli i lëndës:	MATEMATIKA
Mesimdhësi:	Prof.Dr. Fevzi Berisha
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4

Përshkrimi i lëndës:	Lënda ka të bëjë me përvetësimin e njohurive nga matematika që janë të nevojshme për lehtësimin e fitimit të njohurive nga lëndët tjera dhe zbatimin e njohurive në problemet nga arkitektura. Paraqiten elementet e nevojshme nga bashkësitë numerike sidomos nga bashkësia e numrave realë. Njohurit nga matrica dhe përcaktorët që janë të nevojshme për zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve lineare. Metodot për zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve. Sistemet e ekuacioneve në forma dhe mënyra të ndryshme. Sistemi koordinativ kundrejt në hapësirë. Vektorët në hapësirë dhe veprimet lineare e jo lineare me vektor. Vetit e vargut aritmetik dhe gjeometrik dhe zbatimi i tyre në zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Paraqitja grafike e funksionet themelore elementare . Limiti dhe vazhdueshmëria e funksionit. Derivati i funksioneve elementare dhe në bazë të vetive të derivatit derivatet e secilit funksion. Shqyrtimi dhe paraqitja grafike e funksioneve. Integrali i pacaktuar. Zbatimi i integralit të caktuar në zgjidhjen e disa problemeve nga gjeometria dhe mekanika.
-----------------------------	--

Qëllimet e lëndës:	Studenti do të jetë në gjendje që të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet e matematikës së lartë, me qëllim që ato njohuri ti ndihmojnë si aparat ndihmës në lëndët në të cilat është i domosdoshëm përdorimi aparatit matematikor. Të fitojnë njohuri të nevojshme matematikore për lehtësim të fitimit të njohurive të mëvonshme nga arkitektura
---------------------------	--

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Përfitojnë njohuri dhe shprehje për zgjidhjen e metodave ma efikase në problemet e ndryshme të arkitekturës. Do të jenë në gjendje që njohuritë e fituara nga algjebra lineare dhe gjeometria analitike ti aplikojnë në përvetësimin më të lehtë dhe më të shpejt të përmbajtjeve nga lëndët tjera të parapara me programin e studimeve nga arkitektura.
--	---

Metodat e mësimdhënies:	Frontale dhe individuale me ligjërata dhe ushtrime. Angazhim i studentit gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve për zgjidhjen e detyrave
--------------------------------	--

Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi përfundimtar bazohet në punën e përgjithshme që ka bërë studentin gjatë gjithë semestrit, sipas përqindjes në vazhdim:					
	Vlerësimi i parë	Vlerësimi i dytë	Vijimi i rregullt	Angazhimi	Provimi final	Total
	20%	20%	5%	10%	45%	100%

Literatura primare:	1.Fevzi Berisha-Abdullah Zejnullahu: Matematika , Prishtinë, 2006. 2. Fevzi Berisha: Përmbledhje detyrash të provimit nga matematika1,2,
----------------------------	---

	Prishtinë 2006. 3. Alexis Himonas , Alan Howard - Calculus Ideas and applications, USA, 2003.
Literatura shitesë:	1. Ejup Hamiti – Matematika I, II. Elektro – Prishtinë 2. Isak Hoxha – Matematika I,I Ndërtimtari, Prishtinë 3. Ismet Dehiri – Matematika I,II Fakultet Teknik, Prishtinë

Titulli i lëndës:	HISTORIA E ARTIT
Mesimdhësi:	Prof.Ass.Dr. Florina Jerliu
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Historia e Artit shtjellon krijimtarinë artistike dhe kontekstuale prej parahistorisë deri në kohët bashkëkohore, të shfaqur nëpërmjet dëshmimeve materiale në formë të objekteve dhe imazheve të krijuara nga dora e mjeshtrit, artistit apo arkitektit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me elementet dhe parimet themelore të artit, si dhe veprat më përfaqësuese të artit botëror figurativ dhe aplikativ, në kronologjinë dhe kontekstin e tyre historik, gjeografik dhe artistik; njohja dhe të kuptuarit e periudhës artistike, kategorive artistike dhe veçantive të tyre (arkitekturë, skulpturë, pikturë, fotografi, arti performativ, etj.), drejtimit, stilit dhe mjeshtrit, artistit apo arkitektit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> – interpretojë periudhat artistike në kronologji historike – identifikojë karakteristikat themelore artistike të periudhave historike – analizojë dhe interpretojë veprat e rëndësishme artistike dhe kontekstin e tyre (sipas periudhave stilistike, vendit, drejtimeve, tipeve, strukturës, materialit dhe teknikës së aplikuar) – Aplikojë njohuritë e fituara në kualifikimin e veprave të artit në hulumtimin akademik
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave interaktive, diskutimeve, prezantimeve të punës së studentëve, etj.
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentit 10%, Angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyrat /prezantimet 10%, Vlerësimi nga testet 20%, Provimi final 50%
Literatura primare:	Marilyn Stokstad, Michael W. Cothren (2011) Art History - Volume I. Fourth Edition, Pearson Education, Inc., New Jersey Marilyn Stokstad, Michael W. Cothren (2011) Art History - Volume II. Fourth Edition, Pearson Education, Inc., New Jersey F. Jerliu (2017). Historia e Artit (Shënime ligjëratash), Prishtinë
Literatura shitesë:	David Hopkins (2000). After Modern Art. 1945-2000. Oxford University Press Nigel Spivey (2005). Hoë Art Made the Eëorld. A Journey to the Origins of Human Creativity, Basic Books, USA E.H.Gombrich (1995).The Story of Art. Phaidon Press, USA James Elkin, Ed. (2007). Is Art History Global, Routledge, NY

Titulli i lëndës:	GJUHË ANGLEZE
Mesimdhënesi:	Ardita Ibishi, Lektor
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Kursi i Gjuhës angleze në programin Arkitekture ndërtohet mbi dy fundamente kryesore: (a) Anglishten për Qëllime Specifike që është dominanta e kursit dhe (b) Anglishten e Përgjithshme që ka shtrirje më të ngushtë brenda kursit. Studenti do t'i ekspozohet gjuhës kontekstuale të domenit të arkitektures, ku rrjedhimisht do të jetë i aftë t'i konvertojë në anglisht strukturat dhe njohuritë të cilat apriori i përvetëson, gradualisht dhe paralelisht edhe në kurset e tjera profesionale. Veç kësaj, ai zhvillon edhe aftësinë e të shkruarit profesional relevant me domenin që studion, saqë do të jetë në gjendje të shkruajë emaile formale dhe joformale, rezume, letra motivuese, etj. Kursi është content-based, ku anglishtja specifike është gjuha që do të jehojë në klasë, sakaq fjalët, frazat, klauzolat, shprehjet dhe fjalitë që ai përdor, do të jenë në anglishte.
Qëllimet e lëndës:	Kursi në fjalë synon të maksimizojë performansën individuale dhe kolektive të studentëve, duke frymëzuar interesin e të nxënit dhe duke instaluar një ndjenjë të vetëbesimit në secilin prej tyre. Më tej, anglishtja në këtë program studimi synon t'i bëjë studentët kompetentë në përdorimin e gjuhës kontekstuale, veçanërisht në kontekstin e aftësive të të folurit dhe të shkruarit. Ndër objektivat tjera është që studentët të jenë në gjendje të përdorin literaturë në fushën e tyre të veçantë dhe të marrin pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare dhe diskutime profesionale, lirshëm, me një vetëbesim të shëndoshë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të kursit, studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> • ta pasurojë vokabularin dhe diskursin me terminologji nga fusha e arkitektures; • të flas me korrektësi, rrjedhshëm dhe të përdorë gjuhën kontekstuale pa ndonjë pengesë; • ta përdorë gjuhën angleze në një nivel më të avancuar për nevoja akademike dhe specifike; • të surfojë nëpër webfaqe relevante me fushën e tij specifike të studimit dhe të jetë në gjendje ta kuptojë dhe selektojë materialin që i nevojitet, dhe • të shkruajë emaile, kërkesa dhe letra motivuese në gjuhën angleze.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Që të materializohet ambicja e studentit për të penetruar në tregun global, ai duhet domosdo ta njohë gjuhën angleze me target të veçantë, anglishten e domenit të tij profesional. Prandaj, ky kurs është sa aktual, aq edhe i rëndësishëm pasi studentit ja hap dyert e një zhvillimi profesional, qoftë përmes pjesëmarrjes së tij në konferenca e simpoziume të ndryshme që pashmangshmërisht kontribuojnë në zhvillimin e tij profesional, qoftë përmes avancimit të tij karrikerik në të ardhmen e tij të ndritshme.

Metodat e mësimdhënies:	Metodologjia jonë e mësimdhënies bazohet në stilet kryesorë të të nxënit, pra atij vizual, auditiv dhe kinestetik. Video, tryeza të rumbullakëta, detyra dhe aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin e shkathhtësive të studentëve do ta shoqërojnë metodologjinë tonë të mësimdhënies gjatë gjithë semestrit. Përveç kësaj, metodologjia jonë përfshin punimet në grup, seminarët dhe prezantimet e studentëve. Me pak fjalë, ndërveprimi do të mbizotërojë, dhe është studenti ai që do të jetë në qendër.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi arrihet përmes: Pjesëmarrjes fizike dhe participimit aktiv në ligjëratat: 10%; Punimet Seminarik: 10%; Testit afatmesëm: 20%; Provimit final: 60% Pikët për notë: 92-100 10 ; 81-91 9 ; 70-80 8 ; 60-69 7 ; 50-59 6
Literatura primare:	English for Professional and Academic Purposes; Miguel F. Ruiz-Garrido, Juan Carlos Palmer, Inmaculada Fortanet-Gómez, 2010
Literatura shtesë:	Dictionary of Architecture and Landscape architecture; James Stevens Curl, 2006 Studentët do të pajisen me materiale të ndryshme që lidhen me domenin e tyre të veçantë si: worksheets, tekste, transkripte, etj.

Titulli i lëndës:	BAZAT E PROJEKTIMIT 2
Mesimdhënesi:	Dr.sc. Miranda Rashani
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Temat që trajtohen në këtë kurs janë si në vijim: Banimi dhe banesa, bazat e projektimit të arkitektures së banimit, organizimi i hapësirave, lidhjet funksionale si dhe formësimi i hapësirës së banimit në përgjithësi. Funksionet e banesës, grupet funksionale të banesës, grupi funksional i qendrimit, i fjetjes dhe ai ekonomik.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është njoftimi i studentëve me elementet e objekteve të banimit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të kursit studenti: – Kupton principet themelore të dimensionimit të hapësirës – Ka njohuri mbi elementet e projektimit të objekteve të banimit – Është i aftë të shqyrtojë dhe analizojë komponentet arkitekturale në vepra arkitekturale të tjera si parakusht për nisjen e veprimtarisë vetanake – Kupton problematiken e organizimit themelor funksional të hapësirës për banim – Është i aftë të organizojë një njësi të banimit
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërimi ex-catedra si dhe diskutimi i temave që ndërliken me ligjëratat në mënyrë interaktive me studentë. Ushtrimet zhvillohen përmes detyrave tematike grafike javore që punohen në klasë dhe në shtëpi, si dhe diskutohen në klasë. Detyrat grafike janë detyra individuale.
Metodat e vlerësimit:	Punimet individuale grafike 50%; Kolokuiumi – ushtrimi metodik 1 10%; Kolokuiumi – ushtrimi metodik 2 10%. Provimi me vizatim dhe me shkrim 30%.
Literatura primare:	1. Erneste Jedrashi – Qata: ligjerata 2. Biondic Lj., 2011: Uvod u projektiranje stambenih zgrada, Tehnicka knjiga, Sveuciliste u Zagrebu, Arhitektonski Fakultet, Zagreb 3. De Chiara J., Panero J., Zelnik M., 1995: Time-Saver Standards for Housing and Residential Development, McGraw-Hill International Editions, New York

Literatura shitesë:	1. De Chiara, Panero, Zelnik,2001:Time –Saver Standards for Interior Design and Space Planning,Mc Grow –Hill International Editions, New York
----------------------------	---

Titulli i lëndës:	KONSTRUKSIONET ARKITEKTONIKE 2
Mesimdhënesi:	Xhelal Lloncari, IDA
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Lënda përmban 15 ligjerata analitike mbi elementet konstruktive që e sajojnë objektin Arkitektonik. Duke filluar prej trolit ndërtimor, themelimin , konstrukcionet meskatëshe dhe kulmet e rrafshëta. Në pjesen grafike aftësohen për punimin e planeve zbatuese të objekteve arkitektonike. Prezantimi grafik, koutimi dhe shenimet tjera të nevojshme në projekt.
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me karakteristikat themelore të elementeve konstruktive, mënyrën e punimit të tyre, funksionin, njohtimi me sprovat e konstruktive, fizike dhe teknologjike të tyre. Të aftësohen në punimin e planeve zbatuese të objekteve arkitektonik.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Të dallojnë elementet konstruktive dhe karakteristikat e tyre, - Të vendosin për to në projekt dhe zbatim të objekteve arkitektonik. - Të jenë të aftë të bejnë prezantimin grafik të objekteve në nivel të projektit zbatues (1:50) - Të mendojnë konstruktivisht.
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi është i rregullt me ligjerata grupe që organizohen me metoda audiovizuale. Pjesa tjetër përbehet nga ushtrimet grafike që realizohen me lapsë, bojkinë, fotografi(ose ndonjë teknikë tjetër-nga preferenca e studentit) dhe CAD.
Metodat e vlerësimit:	Punimi Grafik 20%, Vlerësimi i Pare 40 %, Vlerësimi i Dytë 40 %; Studenti i nenshtrohet provimit perfundmitar me shkrim, nese nuk e ka kaluar ndonjeren prej vlerësimeve.
Literatura primare:	Ekstrakt i mësimdhënësit për çdo njësi mësimore. “Konstrukcionet arkitektonike”, Ilija Papanikolla,Tirane.; “Bautzachen” H.-J. Dahmlos; “Baukonstruktionslehre 1” (Gebundene Ausgabe), Otto Frick, Karl Knöll, Dietrich Neumann;
Literatura shitesë:	Building construction illustrated by D.K. Ching and Cassandra Adams, third edition Baukonstruktionslehre 2 (Gebundene Ausgabe) von Otto Frick (Autor), Karl Knöll (Autor), Dietrich Neumann (Autor)

Titulli i lëndës:	REPREZENTIMI ARKITEKTONIK
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Arta Basha Jakupi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	<p>Reprezentimi arkitektonik eshte lende aplikative teorike dhe praktike .Merret me mesimin e shkathtesive te vizatimit arkitektonik, menyres se prezentimit te hapësires dhe prezentimn e skicave skemave, dijagrameve, planeve, detajeve.</p> <p>Vizatimi i porosive arkitektonike dhe menyra e prezentimit te tyre eshte nevojte e cdo procesi projektues dhe paraqet ushtrim te perceptimit dhe te</p>

	imagjinates. Procesi paraqet prezentimin arkitektonik me ane te te cilit me simbole arkitektonike dhe spjegimeve tjera shprehet vete ideja dhe behet projekcioni grafiko-optik i idese themelore.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lendes eshte qe t'i orientoj studentet e arkitektures ne shkathtesit e reprezentimit dhe t'i informoj ata mbi mesimet elementare te vizatimit arkitektonik gjate prezentimit te hapesires dhe prezentimit te vizatimeve, skicave, skemave dhe planeve.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Perdorimi i teknikave te prezentimit arkitektonik - zhvilloj aftesine per te percaktuar reprezentimin e duhur arkitektonik -identifikoj dallimet ne reprezentimet arkitektonike, tek: detyrat shkollore, konkurset, klientet, punekryesit, komunitetet dhe akteret e ndryshem jo arkitekt. - Organizimi dhe reprezentimi i sakte i narracionit, 2D, 3D fizik ose virtual i projektit -Pergjegjesia ndaj planit dhe programit te kesaj lende. -Aplikimi i gjuhes arkitektonike -Preciziteti dhe rregulli i vizatimeve arkitektonike. -Studimi i vizatimit arkitektonik i cili eshte i sakte, analitik, permban dimensione dhe rregull logjik te hapesires; paraqet sintezen e formes, funksionit dhe konstruksionit.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërimi dhe diskutimi i temave që ndërlidhen me ligjëratat në mënyrë interaktive me studentë. Ushtrimet zhvillohen përmes detyrave tematike grafike nje javore që punohen në klasë dhe në shtëpi, si dhe diskutohen në klasë. Detyrat grafike janë detyra individuale.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i punimeve grafike : 50%, Vlerësimi i provimit final: 50%; Vijimi i rregullt; Total (përqindja mesatare) 100%.
Literatura primare:	Ligjëratat të përgatitura nga Prof.asoc.dr.Arta Basha-Jakupi Yee R., (2013) Architectural Drawing-A visual compendium of types and methods, 4th Ed, Wiley
Literatura shtesë:	Mo Zell, Architectural Drawing Course, 2006, Barron's Francis D.K. Ching, (2003) 'Architectural Graphics, 4th Ed, JohnWaley & Sons. INC Lorraine Farrelly, (2008) Representational Technioques, AVA Publishing, LTD.

Titulli i lëndës:	MATERIALET E NDERTIMIT NE ARKITEKTURE
Mesimdhënesi:	Prof.Dr. Naser Kabashi
Statusi i lendes:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Njohurite bazike te aplikimit te materialeve ne etapa te ndryshme kohore ne Inxhinierine e Ndertimit. Vetite e materialeve te ndertimit: Vetite fizike; Mekanike; kimike dhe vetite fiziko mekanike. Guri si material i ndertimit dhe karakteristikat e aplikimit ne inxhinieri te ndertimit. Agregati si produkt i gurit; karkateristikat dhe vleresimi i vetive te agregatit. Materialet argjilore, karakteristikat dhe llojet e materialeve argjilore. Vleresimi i ekzaminimit te vetive te materialeve argjilore bazuar ne Standardet EN. Qelqi si material ne ndertimtari, karakteristikat dhe aplikimi.Lendet lidheseme prejardhje inorganike: gelqerja; allcia dhe cimentoja Betoni dhe perdorimi i betonit . Llojet e llacnave dhe karkateristikat. Celiku,metalet e lehta, karkateristikat dhe krahasueshmeria me materialet tjera,Druri, druri i lameluar dhe karakteristiakt .Materialet termoizoluese dhe hidroizoluese.

Qëllimet e lëndës:	Te aftesoje studentet ne njohurite per materialet e ndertimit; vetite e tyre dhe ekzaminimet e vetive me qellim te perdorimit ne fushen e arkitektures ne pozicione te ndryshme
Rezultatet e pritshme të nxënies:	-te njohë materialet e spjeguar, qe jane perdore me kohen -te percaktoje karakteristikat fizike, mekanike, kimike dhe fiziko-mekanike te materialeve -te perdore materialet adekuate per pozicionet dhe objektet perkatese -bazuar ne te arriturat dhe zhvillimin teknologjik te mund te beje ndonje avansim eventual
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Zhvillimet e arkitektures dhe kerkesat per materiale konvencionale te ndertimit e poashtu per materiale bashkekohore kane rendesine primare ne realizimin e nje objektidhe me kete mbahet aktualiteti i kohes.
Metodat e mësimdhënies:	- <i>Ligjëratat me prezantim dhe demonstrime praktike të materialeve te ndertimit</i> - <i>Ushtrimet numerike dhe laboratorike</i> - <i>Seminar semestral me detyra konkrete.</i> - <i>Diskutime gjatë ligjëratave.</i> - <i>Ushtrime në grupe.</i>
Metodat e vlerësimit:	<i>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%. Vijueshmëria e studentit 15%; Detyrat individuale të kryera në klasë 5%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 10%; Vlerësimi nga testet 15%; Provimi final 55%.)</i>
Literatura primare:	1/N.Kabashi- Materialet Ndertimore –Arkitekture-(dispense) 2/Prof asoc. Fisnik Kadiu: Teknologjia e Materialeve te Ndertimit
Literatura shtesë:	3/ N Kabashi: Materialet Ndertimore(Ligjerata +Ushtrime) 4/Neil Jackson and Ravindra K. Dhir: CivilEngineering Materials 5/K.van Breugel: Simulation of hydration and formation of structure in hardening cement-based materials 6/Schaffler/Bruz/Schelling: Bausstoffkunde

Titulli i lëndës:	HISTORIA E ARKITEKTURES-ANTIKA
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Teuta Jashari Kajtazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Historia e Arkitekturës në përgjithësi nënkupton të dhënat mbi zhvillimet në arkitekturë të cilat janë në plotësim të vazhdueshëm. Historia e Arkitekturës - Antika është pjesë e historisë e cila nënkupton të dhënat mbi Arkitekturën e Shekullit të vjetër duke filluar nga Parahistoria e deri tek zhvillimet në kuadër të Romës klasike.
Qëllimet e lëndës:	Ka për qëllim njohjen e formave arkitekturore që nga fillimi i njerëzimit duke vazhduar më pas me format e thjeshta të përsëritshme në Egjipt, Mezopotami dhe Persi, dhe duke arritur kështu deri te format e zhvilluara të tempujve në

	Greqi dhe tek tipologjia komplekse e Romës. Ne kuader te lendes perfshihen edhe te dhenat mbi arkitekturen ne trojet shqiptare, te cilat i takojne Shekullit te vjeter.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Padyshim do të kuptohet se njerëzimi është ai i cili e zhvilloi arkitekturën (shkencën dhe artin e ndërtimit) duke arritur poashtu të kuptohet magjia e shëndërrimit apo kalimit nga një kasolle e thjeshtë deri te veprat e vërteta të artit/ arkitekturës. Studentët ndër të tjera do të fitojnë njohuri më të thella mbi orderet/rendet stilike në arkitekturën e lashtë/ antike si dhe do të shohin lidhshmërinë e arkitekturës me kushtet e përgjithshme historike.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata/ Leksione teorike Ligjërata praktike/ ushtrime – Do të kenë në përmbajtje: - Punim individual semestral/ Albumin e skicave/punimeve, i cili ne menyre vizuele do te i percjelle ligjeratat teorike. Cdo periudhe kohore apo arkitekture do te prezantohet me me se paku tri skica/punime.
Metodat e vlerësimit:	Detyra semestrare_50% Vijimi i rregullt dhe aktiviteti_10% Testi-1_20%, Testi-2_20% (apo Provimi_40%) Totali_100% - Studentet kane poashtu mundesi te bejne prezentimin individual apo ne grup (me me se shumti dy pjesemarres), me c’rast perfitojne 5% shtese ne vleresimin final. - Studentet te cilet arrijne vleresim pozitiv ne testin e pare, kane te drejte te i nenshtrohen testit te dyte ne lende.
Literatura primare:	- <i>Teuta Jashari-Kajtazi</i> , Ligjeratat dhe Prezentimet, te cilat do te shperndahen pas cdo njesie te ligjeruar - <i>A Global History of Architecture; Francis D.K. Ching, Mark Jarzombek, Vikramaditya Prakash, 2010</i> - <i>A World History of Architecture; Michael Fazio, Marian Moffet, Lawrence Wodehouse, 2003</i>
Literatura shitesë:	- <i>Historia e Arkitekturës (The Story of Architecture) – Jonathan Glancey, 2003</i> - <i>Arkitektura – Historia Vizuele/ pamore (Architecture – the visual history) – James Neal, 2017</i> - <i>Artan Krasniqi; Monument (vellimet 1-5), 2017</i>

Titulli i lëndës:	KOMPOZICIONI DHE ANALIZAT ARKITEKTONIKE
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Flamur Doli
Statusi i lendes:	Obligative
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Kompozicioni dhe analizat arkitektonike lidh teorine dhe dizajnin duke u fokusuar ne procesin e te dizajnuarit, formave te ndryshme te shprehjes, teknikave te prezentimit dhe menyres se si arkitektura mund te perceptohet. Kjo lende trajton potencialin e mënyrave të ndryshme të analizave, eksperimentimit dhe prezentimit te projekteve arkitektonike. Për më tepër, seminari trajton tema dhe çështje të ndryshme të procesit të dizajnit duke

	filluar nga koncepti dhe narrativa në materializim, nga përbërja në perceptim. Së pari, ushtrimet, leksionet dhe seminarët janë të dizajnuara për të dhënë aftësi specifike që lidhen me gjenerimin dhe përfaqësimin e objekteve të dizajnuara. Këto shkathtësi shkojnë nga teknikat e vizatimit me dore, deri te ndërtimi i modelit fizik, skicimet, diagramet dhe analizat.
Qëllimet e lëndës:	Përgatitja themelore për prezantimin profesional dhe teknik të projekteve arkitektonike, zhvillimin e aftësive për kuptimin e të menduarit analitik dhe kompozicionit në kontekst të artikullimit të nocioneve themelore në profesionin e arkitektures. Lënda bënë pjesë në grupin e lëndëve përgatitore dhe mundëson përfitimin e njohurive bazike për studime të mëtejme në lëmin e Arkitektures dhe të projektimit arkitektonik.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - aftësia për të komunikuar idetë dhe projektet e tyre përmes vizatimit, pasi përfaqësimi është një nga format kryesore të gjuhës për komunikimin e arkitekturës. -kuptojne modele dhe metoda te ndryshme te hulumtimitreprezentimit arkitektonik me qëllim të informimit të vetë procesit të projektimit. - Eksploron qasje dhe teknika të ndryshme të dizajnit / hulumtimit duke përfshirë perceptimin e objekteve arkitektonike. - Punoni dhe eksperimentoni me kufizime të ndryshme për të përcaktuar një qasje individuale të dizajnit. -aftesine per te paraqitur arkitekturen nepermjet vizatimit, duke perfshire qartesine konceptuale, kompozicionin, analizat dhe menyren e prezentimit. - t'u mundësojë studentëve të analizojnë arkitekturën përmes diagrameve dhe leximit të vizatimeve teknike dhe hartave. - të identifikojnë vetë metodat dhe teknikat e prezentimit më të përshtatshme për komunikimin e punës së tyre. Për shkak të zhvillimit të aftësive të vëzhgimit, vizualizimit dhe shprehjes së formave hapësinore nëpërmjet zotërimit të vizatimit si një mjet për arsyetim dhe përfaqësim.
Metodat e mësimdhënies:	Metoda e të mësuarit të lëndës konsiston në mbajtje të ligjeratave dhe mbajtje të ushtrimeve për njësi të veçanta mësimore të përjavshme, pastaj në punimin e grafikoneve dhe modeleve – maketave për njësi të caktuara mësimore.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i pare; Vlerësimi i dytë; Vlerësimi i ushtrimeve; Vlerësimi i maketave; Vijimi i rregullt; Provimi final; Total (përqindja mesatare) 100%.
Literatura primare:	<p>Ligjëratat të përgatitura nga Prof.asoc.dr.Arta Basha-Jakupi</p> <p>Roger H. C., & Pause M., (2012) Precedents in Architecture: Analytic Diagrams, Formative Ideas, and Partis. Hoboken, NJ: John Wiley & Sons.</p> <p>Di Mari A., (2012) Operative Design: A Catalog of Spatial Verbs, BIS Publishers</p> <p>Unwin S., (2014) Analysing Architecture, Routledge</p> <p>Norman C., & Laseau P., (1984) Visual Notes for Architects and Designers. New York: Van Nostrand Reinhold.</p> <p>Francis Ch.,& Juroszek S., (2010) Design Drawing. 2nd ed. Wiley</p>
Literatura shitesë:	<p>Evans R., (2010) "Translations from Drawing to Building." In Translations from Drawing eatherbarrow, David. "Architecture Is Its Own Discipline."</p> <p>Robbins, E. (1997)Why Architects Draw. MIT Press.</p>

Titulli i lëndës:	ARKITEKTURA DIGJITALE DHE MODELIMI
Mesimdhësi:	Prof.Asoc.Dr. Flamur Doli
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	<p>Aftësitë fizike dhe digjitale të projektimit janë çelësi për praktikuesit e artit, dizajnit dhe inxhinierisë, si dhe shumë profesione të tjera krijuese. Modelet janë thelbësore në arkitekturë. Në praktikën e projektimit, përdoren të gjitha llojet e modeleve, si në shkallë fizike njeashtu dhe modelet digjitale.</p> <p>Në këtë kurs të arkitekturës, studentët do të fitojnë përvojë që do t'u ndihmojë për të çuar përpara zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Studentët do të arrijnë aftësitë në një mënyrë praktike. Së pari, kursi do të përqendrohet në modelet e skematike për fazat e hershme të procesit të dizajnit, atëherë do të vazhdojë me prezentimet virtuale për komunikimin e dizajnit dhe më në fund do të përdoren modele më të detajuara për zhvillimin e mëtejshëm të ideve.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i këtij kursi është rritja e aftësisë së studentit për të komunikuar dhe vlerësuar idetë e dizajnit përmes përdorimit të vizualizimit 3D të projektimit, me ndihmën e kompjuterit dhe modelimit fizik. Studenti mëson bazat e dizajnit digjital dhe mjetet e fabrikimit me ushtrime kreative të dizajnit, të cilat e theksojnë procesin dhe vlerësimin si çelës për dizajnimin në mediumet digjitale. Kursi është software neutral, duke i lejuar studentit të zgjedhë softuerin me të cilin do të redaktoj grafikën dhe të modeloj objektet digjitale. Paraqitja e qartë për konceptet dhe termat kyçe ndihmon studentet në eksperimentimin dhe ndërtimin e shkathtësive të tyre digjital. Gjatë ushtrimeve të fabrikimit studenti do të mësojë strategjitë për prerjen me lazer, prerjen e shkumës dhe printimin 3D për t'i ndihmuar ata të përqendrohen në proceset e të menduarit të projektimit.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Mendimi kreativ: mëson si të zhvillohet një ide arkitekturore duke përdorur modele fizike dhe digjitale.</p> <p>Njohja e Projektimit: eksploron 'konceptin e shkallës' për t'u lidhur me kontekstin dhe për të zhvilluar më tej detajet.</p> <p>Mësoni duke bërë: eksperimenton për të kuptuar përbërjen hapësinore, materialet dhe ergonomikën.</p> <p>Teknologjia Digjitale: përjetoni potencialin e Realitetit Virtual dhe të Augmentuar në dizajnin arkitekturor.</p>
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërimi dhe diskutimi i temave që ndërlidhen me ligjëratat në mënyrë interaktive me studentë. Ushtrimet zhvillohen përmes detyrave tematike grafike dhe modeluese nje javore që punohen në klasë dhe në shtëpi, si dhe diskutohen në klasë. Detyrat grafike janë detyra individuale.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i punimeve grafike : 50%, Vlerësimi i provimit final: 50%; Vijimi i rregullt; Total (përqindja mesatare) 100%.
Literatura primare:	Ligjëratat të përgatitura nga Prof.asoc.dr.Arta Basha-Jakupi Spiller N., (2009) Digital Architecture Now: A Global Survey of Emerging Talent, Thames & Hudson

	Bills, M. C. (2011) Designing with Models: A Studio Guide to Architectural Process Models, Wiley Congdon R. T., (2010) Architectural Model Building: Tools, Techniques, and Materials, Fairchild Books
Literatura shtesë:	Melendez F., (2019) Drawing from the Model: Fundamentals of Digital Drawing, 3D Modeling, and Visual Programming in Architectural Design, Wiley Kolarevic B., (2003) Architecture in the Digital Age: Design and Manufacturing, Taylor & Francis Johnson J., & Vermillion J., (2016) Digital Design Exercises for Architecture Students, Routledge

Titulli i lëndës:	PROJEKTIMI 1 – BANIM INDIVIDUAL
Mesimdhësi:	Dr.sc. Miranda Rashani
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Projektimi, organizimi hapësor dhe teknologjia e objekteve të banimit individual në këtë lëndë do të diskutohen dhe do të realizohen si ushtrime praktike të studentëve: Metodologjia e projektimit të banesave individuale; tipet e objekteve të banimit individual nga aspekti urbanistik; analiza e organizimit të banesës /shtëpisë/; tipologjia e objekteve individuale dhe fleksibiliteti dhe arkitektura e objekteve .
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është njoftimi i studentëve meprojektimin, organizimin hapësor dhe teknologjinë e ndërtimit të objekteve të banimit individual.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të kursit studenti: Fiton njohuri për projektimin e objekteveindividuale të banimit – shqyrton dhe analizon komponentët arkitekturale në vepra arkitekturale të tjera si parakusht për nisjen e veprimtarisë vetanake; – kupton problematikën e organizimit themelor funksional të hapësirave të dedikuara për banim individual; – kuptonrendesine dhe kompleksitetine nevojave të banimit për njerun – njihet meformat e banimit në mes të banimit individual dhe shumebanesore
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërimi ex-catedra si dhe diskutimi i temave qëndërlidhen me ligjeratat në mënyrë interaktive me studentë. Ushtrimet zhvillohen përmes detyraves tematike grafike 2-3 javore që punohen në klasë dhe në shtëpi, si dhe diskutohen në klasë. Detyrat grafike janë detyra individuale.
Metodat e vlerësimit:	Punimet individuale grafike 50%; Kolokuiumi – ushtrimi metodik 1 10%; Kolokuiumi – ushtrimi metodik 2 10%. Provimi me vizatim dhe me shkrim 30%.
Literatura primare:	1. De Chiara J., Panero J., Zelnik M., 1995: Time-Saver Standards for Housing and Residential Development, McGraw-Hill International Editions, New York.

	<ol style="list-style-type: none"> 2. Prof. Dr. Rajka Mandic, 'PROJEKTOVANJE 2 (STANOVANJE I, II)', Arhitektonski Fakultet u Sarajevu. 3. Knezevic – Kordis, 'STAMBENE I JAVNE ZGRADE', Tehnicka knjiga, Zagreb
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Adler, D., METRIC HANDBOOK – Planning and Design Data (2nd edition), Architectural Press, OXFORD, 2000 2. Baiche, B. Walliman, N., Neufert-Architects' Data (third edition), Oxford, 2000 3. Ramsey /Sleeper, Architectural Graphic Standards, The American Institute of Architects, Ninth Edition, New York, 1994 4. Philip Jodido, 'New Forms – Architecture in 1990', Taschen, 5. The Phaidon Atlas of Contemporary World Architecture

Titulli i lëndës:	KONSTRUKSIONET ARKITEKTONIKE 3
Mesimdhënesi:	Prof.Dr. Violeta Nushi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Ky kurs është një hyrje intensive për disiplinën e konstruksioneve arkitektonike dhe njohurive relevante drejt të kuptuarit të konceptit, elementeve dhe tërësisë së konstruksionit të objekteve arkitektonike. Lënda zhvillohet nëpërmjet mësimëve teorike dhe praktike, përmbajtja e të cilave fillimisht bëhet nga temat e sistemeve konstruktive të komunikimit vertikal, hapjeve arkitektonike dhe tipologjive të dyshemeve, me njësi metodike, si: shkallët, ashensorët, eskalatorët, dyert, dritaret, fasadat, etj.
Qëllimet e lëndës:	Përgatitja themelore për të kuptuar dhe prezantuar konceptin, elementët dhe tërësinë e konstruksionit të elementëve konstruktiv arkitektonik. Përkatësisht zhvillimin e aftësive për të menduar projektimin dhe realizimin e sistemit dhe të elementëve të konstruksionit, në harmoni me materialet relevante dhe në kontest me nevojat për hartimin dhe artikulimin e planeve zbatuese arkitektonike – ndërtimore dhe urbane.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - të njohohen me përmbajtjen kryesore të konstruksionit të elementëve arkitektonik dhe zbatimin e tyre, në mënyrë që t'i bëjë ata të aftë të projektojnë dhe të propozojnë elementin konstruktiv (shkallët, ashensorët, eskalatorët, dyert, dritaret, etj., sipas planeve zbatuese arkitektonike e ndërtimore. - të njohohen për aplikueshmërinë e standardeve dhe kodeve të ndërtimit - të aftësohen për të menduar më mënyrë konstruktive gjatë sajimit të planeve zbatuese, - të aftësohen në lëmin e infografikës për projektet arkitektonike - të aftësohen për aplikueshmërinë e projekteve arkitektonike dhe konstruksioneve të qëndrueshme.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata / Leksione teorike Ushtrime praktike – punimin e grafikëve dhe diagrameve, eventualisht modeleve, të elementëve arkitektonike e konstruktive, sipas njësisve mësimore.

Metodat e vlerësimit:	Vijimi i rregullt (10%); Vlerësimi i ushtrimeve/maketave (40%) Provimi final (60%); Total (përqindja mesatare) 100%. Studentët kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit vetëm nëse arrijnë vlerësim pozitiv në Vlerësimin e ushtrimeve.
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Violeta Nushi</i>, Ligjëratat të Prezantimet, përditësuar çdo vit akademik 2. <i>Ilia Papanikolla</i>, Konstruksionet arkitektonike 3. <i>D.K. Ching and Cassandra Adams</i>, Building construction, Third edition 4. <i>Djuro Peulic</i>, Konstruktivni elementi zgrada 1 dhe 2
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Karl Knöll, Dietrich Neumann, Von Otto Frick</i>, Baukonstruktionslehre 1 2. <i>Karl Knöll, Dietrich Neumann, Von Otto Frick</i>, Baukonstruktionslehre 2

Titulli i lëndës:	TEORIA E STRUKTURAVE
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc. Misin Misini
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Teoria e strukturave studion fushat e ndërlidhura nga statika - sistemet e forcave të jashtme që veprojnë në elementet strukturore - dhe rezistenca e materialeve - forcat e brendshme dhe deformimet që rezultojnë nga forcat e jashtme. Ndërlidhja e statikës dhe rezistencës së materialeve krijon një bazë teorike dhe shkencore për të kuptuar teorinë strukturore. Qëllimi i këtij kursi është t'i japë studentëve njohuri nga teoria e strukturave si bazë e projektimit strukturor. Organizativisht, lënda përfshijë: Supozimet bazë në Teorinë e strukturave, Hyrje në statikë, Sistemi i forcave, Ekuilibri i forcave komplanare, Analiza e mbajtësit kapriatë, Analiza e mbajtësit të plotë, Diagramet e forcave të prerjes, Nderja aksiale, Karakteristikat gjeometrike të figurave plane, Momentet e inercisë, Përkulja, Përdredhja, Sistemet statikisht të papërcaktuara. Aspekte nga veprimet anësore të strukturave.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është t'i japë studentëve njohuri nga Teoria e strukturave me qëllim që ato njohuri ti ndihmojnë si aparat ndihmës në lëndët në të cilat është i domosdoshëm përdorimi i koncepteve bazë nga kjo lëndë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentet që përfundojnë me sukses këtë kurs do të jenë në gjendje të: - Përvetësojnë konceptet bazë nga Teoria e Strukturave; - Të kuptojnë rëndësinë e zgjidhjes për problemit; - Njohuri mbi funksionet dhe efektet e forcave në një trup dhe konceptin e ekuilibrit të trupit; Njohuritë e fituara ti aplikojnë në përvetësimin më të lehtë në lëndët tjera të parapara me programin e studimeve.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimi duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale.

Metodat e vlerësimit:	<p>Studentët vlerësohen në bazë të pjesëmarrjes së tyre të mësim dhe performancës së treguar në detyra dhe provime. Rastet studimore duhet të prezantohen në mënyrë të plotë dhe të organizuar.</p> <p>(Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%.</p> <p>Vijueshmëria e studentit 5%;</p> <p>Detyrat individuale të kryera në klasë 5%;</p> <p>Detyrat individuale të kryera në shtëpi 5%;</p> <p>Vlerësimi nga testet 35%;</p> <p>Provimi final 50%.)</p>
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. F. Jagxhiu: Mekanika – Statika, UP, Prishtinë, 1997 2. F. Jagxhiu: Rezistenca e materialeve I, Prishtinë 1995 3. N. Pojani: Teoria e strukturave – I,II,III,IV, Tiranë, 2016
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Barry Onouye with Kevin Kane- Statics and Strength of Materials for Architecture and Building Construction, University of Washington., Prentice Hall, 2012; 2, G. G. Schierle- Structure and Design, University of Southern California, Los Angeles, University Readers, 2008);

Titulli i lëndës:	SISTEMET BASHKËKOHORE TË NDËRTESAVE 1
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Mimoza Dugolli
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	<p>Sistemet bashkëkohore luajnë një rol qendror në komplekset e sotme të ndërtesave dhe funksionimi i mirë i tyre siguron një shfrytëzim të gjatë të këtyre objekteve. Varësisht nga shkalla dhe standardi sipas të cilit janë ndërtuar objektet, sistemet e tyre marrin prej 25% deri në 50% të kostos të përgjithshme të tyre. Kështu që janë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të projektit, shumica e sistemeve të ndërtesave kryejnë edhe funksione shërbimi, kështu që kjo i bën këto komponent integral të objekteve. Përveç kësaj, sistemet duhet zhvillohen ashtu që të përmbushin kërkesat e shfrytëzuesve të tanishme dhe atyre të ardhëm, me fokusin e veçantë në arrijtjen e parametrave kyç siç janë atyre në fasade, strukturë etj ashtu që nevoja për aktivizimin e këtyre sistemeve të mbetet minimale.</p>
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë ka për qëllim të ofrojë njohuri për të gjitha sistemet esenciale të ndërtesave që janë relevante me standardet aktuale si dhe ato të teknologjise së fundit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Ne fund të këtij kursi studentet do të kenë njohuri për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Performancën e ndërtesave dhe komforin që kërkohet për të qenë ato funksionale, • Sistemet pasive të ventilimit, • Sistemet pasive të ftohjes, • Sistemet pasive të ngrohjes, • Sistemet e integruara, • Sistemet aktive të ventilimit, • Sistemet aktive të ngrohjes,

	<ul style="list-style-type: none"> Sistemet aktive te ftohjes,
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	<p>Kjo lëndë është e rëndësishë së veçantë për studentet e arkitekturës për arsye se sistemet e ndërtesave janë realisht ato që e jetësojnë një ndërtesë. Pa përdorimin e këtyre sistemeve, nuk do të arrinin të plotësoheshin as kërkesat minimale për një shfrytëzueshmëri të shëndoshe të ndërtesave nga ana shfrytëzuesve dhe rrjedhimisht dizajnet arkitektonike nuk do të arrinin qëllimin kryesorë të tyre, të shfrytëzoheshin nga njeriu.</p> <p>Dizajnet e ndërtesave duhet të kenë trajtimin e veçante gjate fazës së projektimit, dhe shpesh here p.sh. për të ndërlidhur një dizajn enterieri dhe sistemet e objekteve nevojitet një mjeshtri e posaçme. Përveç kësaj, arkitektet e zgjuar arrijnë që këto sisteme të integrojnë edhe në estetikën e objekteve duke realizuar enteriere dhe hapësira të këndshme dhe të njëjtën kohë të sigurojnë funksion adekuat të sistemeve.</p>
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi do e realizohet përmes ligjëratave, ushtrimeve, detyrave ne grupe, vizitave në punishte.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit 10%; Detyrat individuale të kryera në klasë 15%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 15%; Vlerësimi nga testet 60%; Provimi final 100%.
Literatura primare:	Ligjëratat e përgatitura nga profesori i lëndës; Klaus Daniel, “Advanced Building Systems” A technical guide for architects and engineers, Corky Binggeli “Building Systems for Interior Designers” 3rd Edition
Literatura shtesë:	Ting-pat So, Albert, Wai Lok Chan “Intelligent Building Systems” Lisa M. Tucker Sustainable “Building Systems and Construction for Designers” 2nd Edition

Titulli i lëndës:	HISTORIA E ARKITEKTURES-MESJETA
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Teuta Jashari Kajtazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Lënda përmban rrugetimin e zhvillimit të arkitekture pas ndarjes së Perandorisë romake në atë të lindjes dhe të perëndimit, nëpër periudhën mesjetare përfshirë Gotikën dhe zhvillimet në kuadër të Perandorisë Osmane
Qëllimet e lëndës:	Përmes strukturave dhe tipologjive të shumëllojshme të ndërtuara që nga shekulli i VI-te e deri në shekullin XV, do të prezantohen karakteristikat arkitekturale, hollësitat, shtrirja dhe shumë komponente tjera të rëndësishme të vecante për periudhat e prezantuara
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Njohuri mbi rrethanat shoqërore, vetedijen arkitekturale të periudhave siç janë: Bizanti, Romanika dhe tranzicioni në Gotikë, Arkitektura islame dhe fillimet e saj, Katedralet madhështore të Gotikës, kështjellat/ fortifikatat e kesaj periudhe si dhe karakteristikat e Gotikës së vonshme të cilat do të mundësojnë lidhjen me Renesancën (e cila pason në semestrin në vazhdim). Do të

	mundesohet poashtu njohja me zhvillimet ne arkitekturen kosovare (si dhe ne regjion) ne periudhen e Mesjetes
Metodat e mësimeve:	Ligjërata tematike, analiza e shembujve praktik nëpërmes projeksioneve vizuale Ushtrimet: Albumi i punimeve ne formatin A4 dhe paus/hamer, nepermes te te cilit prezentohen peudhat e shpjeguara ne ligjerata. Teknika e prezentimit eshte e lire (laps grafik, rapitograf, ngjyra...)
Metodat e vlerësimit:	Detyra semestrare / Albumi: 50% Vijimi i rregullt dhe aktiviteti: 10% Testet (dy teste) ose Provimi final: (2x20%) 40% Totali: 100% - Studentet te cilet bejne prezentimin ne temat e zgjedhura (si shtese ne raport me detyren semestrare), do te kene mundesi te fitojne 5% te vleresimit bonus ne vleresimin e pergjithshem/final.
Literatura primare:	<i>Teuta Jashari-Kajtazi</i> : Ligjëratat në trajtë dispense/me prezantime të bashkangjitura (ne forme elektronike); - A Global History of Architecture; <i>Francis D.K. Ching, Mark Jarcombek, Vikramaditya Prakash</i> , 2010 - A World History of Architecture; <i>Michael Fazio, Marian Moffet, Lawrence Wodehouse</i> , 2003
Literatura shitesë:	- Historia e Arkitekturës (The Story of Architecture) – <i>Jonathan Glancey</i> , 2003 - Arkitektura – Historia Vizuele/ pamore (Architecture – the visual history) – <i>James Neal</i> , 2017 - <i>Artan Krasniqi</i> ; Monument (vellimet 1-5), 2017

Titulli i lëndës:	CAD
Mesimdhësi:	Prof.Asoc.Dr. Arta Basha Jakupi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Studentët do njoftohen me një hyrje të gjerë te punes në Computer Aided Design (CAD) 2-dimensionale dhe 3-dimensionale dhe modelim me një fokus në aplikacionet specifike të inxhinierise ndertimore dhe arkitekturës, duke përfshirë Building Information Modeling (BIM). Nxënësit do të mësojnë se si të përdorin programet kryesore të programeve CAD të industrisë për të modeluar projektet e ndërtimit, dhe pastaj të krijojnë dhe shpërndajnë vizatime me bazë arkitekturore të standardeve industriale.
Qëllimet e lëndës:	Kuptimi i praktikës së programit CAD dhe avancimi në përdorimin e vizatimit ne projektet arkitektonike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	-Kuptimi i rendesise dhe saktësisë së modelimit dhe hartimit të kompjuterizuar; -Aftësi për të ndërtuar gjeometri të saktë 2D si dhe forma komplekse 3D dhe objekte sipërfaqësore; -Aftësia për të krijuar paraqitjet 2D të objekteve 3D si pamje plan, lartësi dhe prerje;

	-Aftësia për të mbledhur këto vizatime në formën e standardit të industrisë dhe për të prodhuar kopje fizike të projekteve; - Kuptimi i hartimit arkitekturor me fokus në standardet e industrisë. - Kuptimi për Parimet e Building Information Modeling (BIM).
Metodat e mësimdhënies:	Metoda e të mësuartit të lëndës së Gjeometrisë deskriptive konsiston në mbajtje të ligjeratave dhe mbajtje të ushtrimeve për njësi të veçanta mësimore të përjavshme, pastaj në punimin e detyrave për njësi të caktuara mësimore.
Metodat e vlerësimit:	Prezenca e studentit 5%; Vlerësimi i Parë 35%; Vlerësimi i dytë 35%; Puna individuale 25%, provimi përfundimtar për ata që nuk kanë kaluar vlerësimin e parë dhe të dytë.
Literatura primare:	Ligjëratat të përgatitura nga Prof.asoc.dr.Arta Basha-Jakupi Omura G., & Sybex A., (2018) Mastering AutoCAD and AutoCAD LT, J. Wiley & Sons
Literatura shpeshë:	Onsott S.,(2018) AutoCAD and AutoCAD LT, John Wiley & Sons

Titulli i lëndës:	HYRJE NË PROJEKTIMIN E OBJEKTEVE PUBLIKE
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Vlora Navakazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Hyrje, zanafilla dhe zhvillimi i arkitekturës së ndërtesave publike; Llojet, analiza, ndarja dhe kategorizimi i objekteve publike; Ndërtesat e administratës, ndarja, vendndodhja, karakteristikat e përgjithshme, analiza strukturore e elementeve kryesore, organizimi dhe përmbajtja e njësive të punës në sistem të mbyllur; lëvizshmëria dhe fleksibiliteti i vendeve të punës dhe njësive, sistemi i hapur, shembujt e objekteve karakteristike; Ndërtesat shkollore, tipologjia, shkollat fillore, lokacioni, njësitë funksionale, përmbajtja dhe karakteristikat e tyre; Njoftim me realizime të objekteve shkollore në vend dhe në botë, tendencat në arkitekturë; Objektet sportive, qëllimi, ndarja, vendndodhja, orientimi; terrene të lojërave të fëmijëve, salla të shkollave, stadiumet, qendrat sportive; pishinat dhe akuparqe; Zgjidhje arkitekturore moderne në vend dhe botë të objekteve sportive;
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është të nxënit e njohurive bazike me tipologjitë, zhvillimin historik, parimet e projektimit dhe shembujt të ndërtesave publike në Kosovë dhe në botë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas realizimit të kursit studenti duhet të jetë në gjendje që të: - Njoh dhe dalloj llojet e ndryshme specifike të ndërtesave publike; - Kuptoj përfitimet sociale të mjedisit të ndërtuar; - Përcaktoj dhe njoh specifikat funksionale dhe hapësirore të ndërtesave publike; - Definoj dhe analizoj njësitë funksionale dhe hapësirore të ndërtesave publike;
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, mënyra multimediale e prezentimit, komentimi analitik dhe krahasimi përmes të mjeteve të konkretizimit si projektori, lloptopi, tabela;

	ushtrimet e organizuara me punë në grupe (2 deri 3 studentë); vizita në teren, detyra individuale nën mbikëqyrje.
Metodat e vlerësimit:	Me dorëzimim dhe vlerësimin pozitiv të punimit individual/grupor, studenti fiton të drejtën e nënshkrimit. Kriteret e vlerësimit dhe kalueshmërisë në : Prezenca në ligjerata dhe aktiviteti në ushtrime (10%), eseu (15%), Kolokiumi (15%); projekti Individual/grupor (2-3 studentë) (55%); Provimi përfundimtar (5%).
Literatura primare:	1. Adler, D., METRIC HANDBOOK – Planning and Design Data (2nd edition), Architectural Press, OXFORD, 2000 2. Baiche, B. Walliman, N., Neufert-Architects' Data (third edition), Oxford, 2000 3. Pevsner, N., A HISTORY OF BUILDING TYPES, Princeton University Press, 1976.
Literatura shtesë:	4 G. Knezevic, I. Kordis, “Stambene i Javne zgrade”, IRO Tehnicka knjiga, Zagreb, 1981. 5. Architectural Review 1244/2000. - OI Australija

Titulli i ëndës:	QYTETI DHE SHOQERIA
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Dukagjin Hasimja
Statusi i lëndes:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Lënda do të sjellë njohuritë bazë mbi zhvillimet urbane në raport me sfidat dhe lëvizjet shoqërore. Fokus do të jetë roli i institucioneve dhe qytetarëve që ndikojnë çështjet urbane. Por lënda nuk është e limituar në politikat formale urbane apo në mobilizimet shoqërore apo lëvizjet urbane, por zgjerohet në politikat e jetës së përditshme, se si hapësira urbane prodhon të ndryshmen dhe se si të ndryshmet prodhojnë hapësirën urbane, poashtu lëvizja e njerëzve, kapitalit dhe burimeve që përfshihen përbrenda hapësirës urbane dhe mënyra se si këto janë devijohen apo shmangen nga politikat, nga forcat e ndryshme. Andaj do të ketë një përfshirje kritike me konstrukte të ndryshme teorike që përshkruajën “Qytetin Neoliberal, Qytetin e Qëndrueshëm, Qytetin gjinor, Qytetin postcolonial, Qyteti kreativ, Qyteti I lumtur...” etj.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është të shfaq dhe të hulumtojë njëkohësisht çështjet kryesore me të cilat ballafaqohen qytetet. Zonat urbane përgjithësisht janë hapësira të banuara nga grupe të ndryshme etnike, gjinore, seksuale, kulturore ekonomike dhe politike një shumëllojshmëri kjo e cila kërkon një platformë negocijimi mbi të mirat e përbashkëta por që shpesh qon edhe në konflikte dhe përjashtime që manifestohen nëpër lagje dhe qytet.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Njohuritë mbi rrethanat dhe ndikimet shoqërore që e prodhojnë qytetin. Poashtu njohuri mbi konceptet bashkekohorë të qyteteve si ndikim i rrethanave të reja të globalizimit, ekonomive të reja dhe flukesve të reja shoqërore.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata tematike, analize e koncepteve të qyteteve nga perspektiva shoqërore

	Ushtrimet: Seminar me tema mbi ndikimet shoqërore në zhvillimet urbane
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi formativ dhe përmbljedhës (sumative) Detyra semestrale / Ese/ seminari/prezentimi 60% Testet semestrale (2) 40% (apo provimi) Totali 100%
Literatura primare:	1. Bridge & Watson, eds. (2013) <i>The New Blackwell Companion to the City</i> . London: Wiley-Blackwell 2. Davidson & Martin, eds. (2013) <i>Urban Politics: Critical Approaches</i> . London: SAGE. [D&M] 3. Harding & Blokland (2014) <i>Urban Theory: A Critical Introduction to Power, Cities, and Urbanism in the 21st Century</i> . London: SAGE. [H&B] 4. Castells, Manuel – <i>The city and the grassroots: A cross-cultural theory of urban social movements</i> , Edward Arnold
Literatura shitesë:	1. Davies & Imbroscio, eds. (2009) <i>Theories of Urban Politics</i> (2nd Edition). London: SAGE. 2. Dreier, Peter, Todd Swanstrom, and John H. Mollenkopf. 2014. <i>Place Matters: Metropolitcs for the Twenty-First Century</i> . 3rd edition. Lawrence, KS: University Press of Kansas. 3. Sassen Saskia. 1991. <i>The Global City</i> , Princeton: Princeton University Press 4. <i>The Urban Sociology Reader</i> , Jan & Mele, eds 5. <i>The City Cultures Reader</i> , Borden & Hall, eds. 6. <i>The Urban Ethnography Reader</i> . New York: Oxford University Press. 7. Lewis Mumford (1937) “What is a City?”, pp. 183-188 in LeGates T.R. and Stout F. (ed.) <i>The City Reader</i> . Routledge: London and New York. 8. Louis Wirth (1938) “Urbanism as a Way of Life”, pp. 189-197 in LeGates T.R. and Stout F. (ed.) <i>The City Reader</i> . Routledge: London and New York.

Titulli i ëndës:	TOPOGRAFI
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Perparim Ameti
Statusi i lëndes:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Fillimisht zhvillohen njohuritë mbi metodat baze të matjeve dhe llogaritja e koordinatave të pikave të panjohura, sistemet koordinative në gjeodezi, detyrat themelore gjeodezike, aplikimi i matjeve gjeodezike në projektimin e objekteve infrastrukturore. Lënda përfundon me zhvillimin e njohurive bazike mbi GPS si dhe metodat e paraqitjes së relievit në hartë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor e kësaj lënde është të zhvillohen njohuritë bazike mbi aplikimin matjeve gjeodezike me qëllim përcaktimin e topografisë së terrenit dhe paraqitjen e tij në hartë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti duhet që të ketë njohuri në lidhje me: Llojet e sistemeve referente koordinative Sipërfaqet referuese të matjeve gjeodezike Llogaritjen e koordinatave të pikave të panjohura Aplikimi i GPS-it në rievimet gjeodezike

	Metodat e paraqitjes se relievit ne harte
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata te avancuara, diskutime, pune te pavarur, pune ne grupe, prezantime.
Metodat e vlerësimit:	Kolokuiumi 1 10%; Kolokuiumi 2 10%; Detyre shtëpie 5%, Vijueshmëria 20%, Provimi final 55%.
Literatura primare:	Kahmen, H: Vermessungskunde, Berlin, 2005. Nela, K: Gjeodezia Praktike I, Prishtine, Kosove, 2005.
Literatura shitesë:	Idri, B: Topografia (Dispensë), Prishtine, Kosove, 2009

Titulli i lëndës:	PROJEKTIMI 2 – OBJEKTET SHUMËBANESORE
Mesimdhënesi:	Dr.sc. Rozafa Basha
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Projektimi, organizimi hapësinor dhe teknologjia e ndërtimit të objekteve të banimit shumëbanesorë. Trajtohen: Tipologjia e objekteve shumëbanesore; Objektet e banimit me seksione; Objektet e banimit me galeri të brendshme /korridor qendror; Objektet e banimit me galeri të jashtme; Kullat e banimit; Objektet terracore, etj
Qëllimet e lëndës:	Kursi ka për qëllimii njoftimin e studentëve me projektimin, organizimin hapësinor dhe teknologjinë e ndërtimit të objekteve të banimit shumëbanesorë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	- Të zbatojë normat dhe standardet e projektimit të banimit në projektet arkitektonike të tipologjisë së banimit shumëbanesorë; - Të shqyrtojë dhe analizojë komponentët arkitektural në vepra arkitekturale të tjera si parakusht për nisjen e veprimtarisë vetanake; - Të kuptojë problematikën e organizimit themelor funksional të hapësirave të dedikuara për banim te objektet shumebanesore - Te zbatojë tendecat dhe strategjitë e reja projektuese në procesin projektues të krijimit të objekteve te banimit familjar.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Objektet shumëbanesore paraqesin përqindjen më të madhe të stokut ndërtimor, dhe projektimi i këtyre ndërtesave përbëjnë pjesën më të madhe të aktivitetit projektues në nivel global. Andaj, ky kurs ka rëndësi bosht në formësimin profesional të arkitektëve të ardhshëm.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërimiti ex-catedra si dhe diskutimi i temave që ndërlidhen me ligjëratat në mënyrë interaktive me studentë. Ushtrimet zhvillohen përmes detyrave tematike grafike 5 javore që punohen në klasë dhe në shtëpi, si dhe diskutohen në klasë. Detyrat grafike janë detyra individuale.

Metodat e vlerësimit:	Punimet individuale grafike - 50%; Kolokuiumi – ushtrimi metodik 1 - 10%; Kolokuiumi – ushtrimi metodik 2 - 10%. Provimi me vizatim dhe provimi me shkrim - 30%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. De Chiara J.,Panero J.,Zelnik M., 1995: Time-Saver Standards for Housing and Residential Development, McGraw-Hill International Editions, New York 2. Franchini A., Righeti P., 2003: Tipologie residenziali contemporanee, BE-MA editrice, Milano 3. F. Schneider, Floor Plan Manual – Housing, 4th Edition, Birkhauser Architecture, 2011
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. E. Neufert, Architect’s Data, 4 th edition, Wiley Blackwell, 2012 2. K. Chey, Multi Unit Housing, in Urban Cities, from 18000 to present day, Routledge, 2017 3. F. Urban, The New Tenement, Residences in the Inner City since 1970, Routledge, 2017 4. G. Pfeifer, P. Brauneck, Residential Buildings, Birkhauser, 2015 5. G. Knezevic, Visestambene Zgrade, Tehnicka Knjiga, Zagreb,

Titulli i lëndës:	KONSTRUKSIONET ARKITEKTONIKE 4
Mesimdhenesi:	Prof.Dr. Violeta Nushi
Statusi i lendes:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Ky kurs është një hyrje intensive për disiplinën e konstruksioneve arkitektonike dhe njohurive relevante drejt të kuptuarit të konceptit, elementeve dhe tërësisë së konstruksionit të objekteve arkitektonike. Lënda zhvillohet nëpërmjet mësimëve teorike dhe praktike, përmbajtja e të cilave fillimisht bëhet nga temat e sistemeve konstruktive të kulmit të pjerrët nga druri, konstruksioneve bondruk dhe aksesoreve tjerë të mbështjellësit të ndërtesës.
Qëllimet e lëndës:	Përgatitja themelore për të kuptuar dhe prezantuar konceptin, elementët dhe tërësinë e konstruksionit të elementëve konstruktiv arkitektonik. Përkatesisht zhvillimin e aftësive për të menduar projektimin dhe realizimin e sistemit dhe të elementëve të konstruksionit të ndërtesës dhe kulmit të pjerrët nga druri, në harmoni me materialet relevante dhe në kontest me nevojat për hartimin dhe artikullimin e planeve zbatuese arkitektonike – ndërtimore dhe urbane.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - të njoftohen me përmbajtjen kryesore të konstruksionit të elementëve arkitektonik dhe zbatimin e tyre, në mënyrë që t'i bëjë ata të aftë të projektojnë dhe të propozojnë elementin konstruktiv (shtylla, trau, pllaka, muri, elementët e kulmit të pjerrët nga druri, etj., sipas planeve zbatuese arkitektonike e ndërtimore. - të njoftohen për aplikueshmërinë e standardeve dhe kodeve të ndërtimit - të aftësohen për të menduar më mënyrë konstruktive gjatë sajimit të planeve zbatuese, - të aftësohen në lëmin e infografikës për projektet arkitektonike

	- të aftësohen për aplikueshmërinë e projekteve arkitektonike dhe konstruksioneve të qëndrueshme.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata / Leksione teorike Ushtime praktike – punimin e grafikëve dhe diagrameve, eventualisht modeleve, të elementëve arkitektonike e konstruktive, sipas njësive mësimore.
Metodat e vlerësimit:	Vijimi i rregullt (10%); Vlerësimi i ushtimeve/maketave (40%) Provimi final (60%); Total (përqindja mesatare) 100%. Studentët kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit vetëm nëse arrijnë vlerësim pozitiv në Vlerësimin e ushtimeve.
Literatura primare:	5. <i>Violeta Nushi</i> , Ligjëratat të Prezantimet, përditësuara çdo vit akademik 6. <i>Ilia Papanikolla</i> , Konstruksionet arkitektonike 7. <i>D.K. Ching and Cassandra Adams</i> , Building construction, Third edition 8. <i>Djuro Peulic</i> , Konstruktivni elementi zgrada 1 dhe 2
Literatura shtesë:	3. <i>Karl Knöll, Dietrich Neumann, Von Otto Frick</i> , Baukonstruktionslehre 1 4. <i>Karl Knöll, Dietrich Neumann, Von Otto Frick</i> , Baukonstruktionslehre 2

Titulli i lëndës:	HISTORIA E ARKITEKTURËS – KOHA E RE
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Florina Jerliu
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Historia e Arkitekturës – Koha e Re shtjellon krijimtarinë arkitektonike në kontekst dhe kronologji kohore të periudhës historike midis shekujve XV dhe XX. Ilustrimi i trendeve dhe stileve arkitektonike bashkë me kontekstet e zhvillimit të tyre teorik dhe praktik analizohen nëpërmjet shembujve ilustrues të arkitekturës dhe të arkitektëve të cilët e definojnë kuadrin e krijimtarisë arkitektonike dhe urbanistike përgjatë historisë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me veçantitë e periudhave artistike bashkë me elementet dhe parimet e arkitekturës, të aplikuarat prej Renesancës deri te Modena; të përvehtësohen kornizat themelore kronologjike dhe gjeografike të historisë së arkitekturës (arkitektura në kohë dhe hapësirë); të zgjerohet dija mbi kulturën ndërtimore; të njihen fillet e vlerësimit të raporteve midis idesë dhe formës së objektit brenda kontekstit të gjërë të social, politik dhe ekonomik. Të fitohet shkathtësi në analizën arkitektonike të monumenteve botërore dhe parashtrimin e saj në formë eseu sipas standardit akademik.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> – interpretojë veçantitë stilistike të periudhave artistike në kronologji dhe kontekst kohor – interpretojë dhe analizojë veprat arkitektonike dhe veprimtaritë e arkitektëve bashkë me kontekstin dhe idetë e parimet e aplikuarat në realizimet e tyre

	<ul style="list-style-type: none"> – të shkruajë ese (seminar) sipas formatit dhe praktikës akademike, të bëjë referencimet adekuate dhe të aplikojë metodën përshkruese, analitike dhe komparative – Aplikojë njohuritë e fituara në kualifikimin e veprave të arkitekturës në hulumtimin akademik dhe në konceptimin e arkitekturës së kohës sonë.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Njohja e historisë së arkitekturës, përkatësisht, kontekstit historik dhe artistik të veprave arkitektonike dhe urbane kulminante të civilizimit njerëzor përbën referencën themelore të njohurive gjithëpërfshirëse të botës së arkitekturës dhe njëherit burimin e rëndësishëm të dhe të nevojshëm në procesin e rafinimit akademik dhe profesional të studentëve të arkitekturës.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata interaktive, diskutimeve, detyrë shtëpie individuale dhe grupore, prezantime të punës së studentëve.
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyra seminarike dhe prezantimet e studentëve 40%, Vlerësimi nga testet 25% ose Provimi final 50%
Literatura primare:	M. Moffet, M. Fazio, L.Wdenhouse (2004) A World History Of Architecture; P. Nuttgens (1983) The Story Of Architecture; Fletcher, Bannister (1996): A History of Architecture on the Comparative Method; S. Nixha dhe F.Jerliu (2007) Dispencë: Historia e Arkitekturës. Prej Renesancës deri te Moderna. Shekujt XV-XIX
Literatura shtesë:	Trachtenberg, I. Hyman (2003) Architecture From Prehistory To Post-Modernism; Robert Harbison (2009) Travels in the History of Architecture, Reaktion Books L.S.Adams (2001) Key Monuments of the Italian Renaissance, Avalon Publishing Christian Norberg-Schulz (2003) Baroque Architecture, Phaidon Incorporated Limited; R.Toman, A. Bednorz (2010) Neoclassicism and Romanticism, H.F.Ullmann Publishing

Titulli i lëndës:	HYRJE NË URBANIZËM
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Dukagjin Hasimja
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Njohja e elementeve të qytetit dhe njesit kompozicionale të tij duke filluar nga blloku urbanistik i banimit. Çfare është blloku, si dhe nga çfare kompozohet ai. Njohuria për rrjetin e trafikut, ndertesat e banimit duke filluar nga banimi individual e deri në banimi në ndertesa shumëkateshe, pozita dhe llojet e objekteve sociale në kuadrin e bllokut, ndikimi i sportit dhe rekreacionit si dhe gjelbrimit në bllok.
Qëllimet e lëndës:	T'u mundësojë studentëve kuptuarjen me elementet bazë të komponimit të bllokut të përbërë urbanistik dhe të koncepteve themelore të urbanizmit përmes mësimin teorik dhe analizës së fenomeneve urbane.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentet duhet të njohin elementet themelore të komponimit të një blloku urbanistik, të kuptojnë raportin në mes të elementeve të ndryshme brenda bllokut, lidhshmërinë dhe ndikimet mes tyre dhe të njohin standardet dhe rregullat e planifikimit dhe projektimit urban.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata tematike dhe analiza e shembujve praktik me projeksione vizuale Ushtrimet : punimi grafik i zgjidhjes kompozicionale te blloqeve urbane Projekti hulumtues - punë individuale apo grupe 2-3 studentë
Metodat e vlerësimit:	Detyra semestrare 50% Testet semestrare (2) apo provimi 40% Vijimi i rregullt 10%
Literatura primare:	1.Dieter Prinz: Urbanizmi, volum 1 –Creativo,Prishtina -2010 (perkthim) 2.Dieter Prinz: Formesimi urbanistik , volum 2 –Creativo,Prishtina -2012 (perkthim) 3.Urban Design Associates: The Urban Design Handbook, Techniques and Working Methods, W.W. Noton & Company, 2003
Literatura shtesë:	1.Urban Design the composition of complexity -Ron Kasprisin –London & New York-Routledge -2011

Titulli i lëndës:	SISTEMET BASHKËKOHORE TË NDËRTESAVE 2
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Mimoza Dugolli
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Sistemet bashkëkohore luajnë një rol qendror në komplekset e sotme të ndërtesave dhe funksionimi i mirë i tyre siguron një shfrytëzim të gjerë të këtyre objekteve. Varësisht nga shkalla dhe standardi sipas të cilit janë ndërtuar objektet, sistemet e tyre marrin prej 25% deri në 50% të kostos të përgjithshme të tyre. Kështu që janë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të projektit, shumica e sistemeve të ndërtesave kryejnë edhe funksione shërbimi, kështu që kjo i bën këto komponent integral të objekteve. Përveç kësaj, sistemet duhet zhvillohen ashtu që të përmbushin kërkesat e shfrytëzuesve të tanishme dhe atyre të ardhëm, me fokusin e veçantë në arritjen e parametrevë kyç siç janë atyre në fasade, strukturë etj ashtu që nevoja për aktivizimin e këtyre sistemeve të mbetet minimale.
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë ka për qëllim të ofrojë njohuri për të gjitha sistemet esenciale të ndërtesave që janë relevante me standardet aktuale si dhe ato të teknologjive së fundit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Ne fund të këtij kursi studentët do të kenë njohuri për: <ul style="list-style-type: none"> • Centralet për prodhimin e energjisë dhe kërkesat e ndërtesave për energji, • Shpërndarja e energjisë, • Ndriçimi , • Ndriçimi natyral, • Sistemet me voltazha të ulta,

	<ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja kundër zjarrit, • Sistemet hidrosanitare dhe te kanalizimit, • Sistemet transportuese.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	<p>Kjo lëndë është e rëndësisë së veçantë për studentet e arkitekturës për arsye se sistemet e ndërtesave janë realisht ato që e jetësojnë një ndërtesë. Pa përdorimin e këtyre sistemeve, nuk do të arrinin të plotësoheshin as kërkesat minimale për një shfrytëzueshmëri të shëndoshe të ndërtesave nga ana shfrytëzuesve dhe rrjedhimisht dizajnet arkitektonike nuk do të arrinin qëllimin kryesorë të tyre, të shfrytëzoheshin nga njeriu.</p> <p>Dizajnët e ndërtesave duhet të kenë trajtimin e veçante gjate fazës së projektimit, dhe shpesh here p.sh. për te ndërlidhur një dizajn enterieri dhe sistemet e objekteve nevojitet një mjeshtri e posaçme. Përveç kësaj, arkitektet e zgjuar arrijnë që këto sisteme të i integrojnë edhe në estetikën e objekteve duke realizuar enteriere dhe hapësira të këndshme dhe të njëjtën kohë të sigurojnë funksion adekuat të sistemeve.</p>
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi do e realizohet përmes ligjëratave, ushtrimeve, detyrave ne grupe, vizitave në punishte.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit 10%; Detyrat individuale të kryera në klasë 15%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 15%; Vlerësimi nga testet 60%; Provimi final 100%.
Literatura primare:	Ligjëratat e përgatitura nga profesori i lëndës; Klaus Daniel, “Advanced Building Systems” A technical guide for architects and engineers, Corky Binggeli “Building Systems for Interior Designers” 3rd Edition
Literatura shtesë:	Ting-pat So, Albert, Wai Lok Chan “Intelligent Building Systems” Lisa M. Tucker Sustainable “Building Systems and Construction for Designers” 2nd Edition

Titulli i lëndës:	PROJEKTIM - KOMPLEKSET E PARKIMIT STACIONAR
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Arta Xhambazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi i Projektimit Arkitektonik: Komplekset e Parkimit Stacionar diskuton dhe studion temën e projektimit të Komplekseve të Parkimit Stacionar. Kursi zhvillohet një herë në javë dhe është kurs i integruar me pjesëmarrje interaktive të studentëve. Roli kryesor i kursit është të studiojë dhe të hulumtojë tipologjinë e komplekseve multifunkionale bashkëkohore, me theks në tipologjinë: e ndërtesave me shumë funksione të parkimit stacionar, si dhe nga parimet e projektimit të qëndrueshëm. Tipologjinë e strukturave multifunkionale do të caktohen për çdo vit akademik sipas trendeve aktuale në bashkëpunim me studentët dhe referencat ndërkombëtare akademike.</p>

Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është të iniciojë, të përdorë parimet themelore të parimeve teorike dhe praktike arkitekturore të projektimit, duke përfshirë ndërlidhjen simbiotike të avancimit të teknologjisë dhe projektimit arkitektonik. Objektivat kryesore të kursit janë subjekt i qasjeve të ndryshme ndërdisiplinore për të zgjidhur problemet e projektimit arkitektonik, duke ndarë proceset krijuese si një qasje për të identifikuar dhe zgjidhur varietetet e problemeve në arkitekturë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studentët duhet të kenë kuptuar dhe zotëruar parimet themelore projektuese të komplekseve multifunkionale: <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë zhvilluar aftësitë dhe teknikat në projektim dhe aplikimin e koncepteve të ndryshme të projektimit; - Studentët kanë zhvilluar aftësitë e nevojshme për projektim e komplekseve multifunkionale me fokus në parkimin stacionar; - Studentët kanë zhvilluar aftësi dhe teknika për të përshkruar, analizuar dhe artikuluar procesin e projektimit ndërdisiplinor.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Tematika e shtjelluar në kurs korespondon dhe aktualisht është në vijë me trendet bashkëkohore të mësimdhënies në universitetet europiane dhe më gjërë. Për më shumë, studentët janë të pajisur me literaturën primare në gjuhën Shqipe falas, nga mësimdhënësi i kursit.
Metodat e mësimdhënies:	Mësimdhënia ka karakterin e diskutimeve interaktive, duke angazhuar në diskutim të gjithë studentët. Gjithashtu, kursi synon që studentët të marrë pjesë në punë në grup, dhe individuale, të cilët do të marrin detyra konkrete në formën e projekteve ideore arkitektonike. Ligjëratat, dhe ushtrimet gjatë mësimin në klasë përdorin mjete dhe teknika të ndryshme vizuale, kurse gjatë punës me studentë në konsultimet individuale promovohet dhe vlerësohet puna e pavarur në klasë, si dhe angazhimi dhe detyrat e shtëpisë.
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë për kursin: <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e studentit në ligjerata dhe ushtrime, aktiviteti 10% - Vlerësimi obligativ intermediar - Fazat 10% - Portfolio e punimeve grafike, detyrave, seminareve, të vlerësuar me notë - pozitive gjatë semestrit, janë kusht për të marrur ECTS – si dhe janë kusht - për t’iu nënshtruar provimit përfundimtar 50% - Provimi përfundimtar, Test me shkrim. 30%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bujar Bajçinovci, Sustainable Architectural Design – principles, in the Albanian Language, 4 (3), JOSHA, 2017. DOI: 10.17160/josha.4.3.306 2. Bujar Bajçinovci, Commercial Hybrid Buildings - Planning and Design, in Albanian Language 4 (3), JOSHA, Germany. 2017. DOI: 10.17160/josha.4.3.309
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Batty, M., Torrens M.P. (2005). Modelling and prediction in a complex world. London, UK. Salt Lake City, USA: Elsevier. 2. Downton, P. (2009). Architecture & Cities for a Changing Climate. Springer. CSIRO. 3. Orr W. D. (2002). The Nature of Design. Oxford, UK: Oxford Uni. Press.

Titulli i lëndës:	TEKNIKAT E URBANIZMIT
--------------------------	------------------------------

Mesimdhësi:	Dr.Sc. Ilir Gjinolli
Statusi i lëndes:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Shtrirja e lëndes do të bëhet në tri module përmes të cilave shpaloset zhvillimi i qyteteve nëpër kohë. M. 1: Teoria e urbanizmit dhe lindja e qyteteve, dallimi midis koncepteve urbanistike dhe ideja për qytetin, lindjen dhe zhvillimin e tij nëpër kohe. Njohuritë mbi qytetet e Mesopotamisë dhe karakteristikat e tyre fizike dhe kulturore për të vazhduar tutje në elaborimin e qyteteve të Egjiptit dhe qyteteve Greke e Romake si qytete me një organizim të lartë të jetës shoqërore në sensin e kulturës dhe ekonomisë. M.2: Qytetet mesjetare, të rilindjes dhe barokut dhe procesi i industrializimit , ndikimet në shtrirjen hapësinore – formësimin e tij, periudhës së Rilindjes dhe fillimit të ideve për hapjen e qyteteve, zhdukjen e mureve rrethuese dhe shtrirjes së tyre përtej mureve kufizuese të tyre. M.3: Qyteti industrial,qyteti i gjelber –qyteti kopsht, paradigma moderne e zhvillimit të qyteteve dhe qytetet socialiste, si dhe trendet aktuale të zhvillimit të qyteteve, njohja me konceptin e qytetit industrial. Qyteti kopsht si alternativë e procesit të industrializimit. Qytetet moderne, qytete pa klasa, me shërbime për të gjithë si ide për qytetin ideal me të gjitha të mirat dhe mangësitë e tij. Trendet aktual të zhvillimit të qyteteve dhe ideve liberale.
Qëllimet e lëndës:	T'u mundësojë studentëve kuptuarjen e koncepteve urbanistike si shkencë dhe art i krijimit të qyteteve, njohja me zhvillimin e qyteteve në periudhën e Mesjetës, njohja me konceptin e qytetit industrial,qytetit kopsht ,qyteti modern si dhe trendet aktuale të zhvillimit të tyre etj.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentet duhet të njohin tipologjitë e qyteteve nëpër kohë ,të kuptojnë idenë e zhvillimit të qytetit duke u bazuar në faktorët natyror, rendin organizativ shoqëror, nivelin e kulturës dhe zhvillimit teknologjik të kohës, si dhe të kuptojnë trendet aktuale të zhvillimit të qyteteve dhe proceset që i shkaktojnë ato.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjeratë dhe diskutimi në fund të çdo moduli, Projekti hulumtues – seminari, punë individuale
Metodat e vlerësimit:	Projekti hulumtues / Seminari 40% Provimi final 50% Vijimi i rregullt 10%
Literatura primare:	1_Dieter Prinz: Urbanizmi, volum 1 –Creativo,Prishtina -2010 (perkthim) 2_ Lewis Mumford : <i>The City in History: Its Origins, Its Transformations, and Its Prospects</i> is a 1961 3_Jan Lin: The Urban Sociology Reader (Routledge Urban Reader)
Literatura shtesë:	1_Sir Peter Hall : <i>Cities of Tomorrow: An Intellectual History of Urban Planning and Design in the Twentieth Century</i> , 2002

Titulli i lëndës:	SHKENCAT HUMANE DHE ARKITEKTURA
Mesimdhësi:	Prof.Ass.Dr. Arta Xhambazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Lënda ofron bazën e ideologjive dhe sistemeve të besimit të cilat informojnë prodhimin e teorive në arkitekturë që pastaj depërtojnë në vet ndërtesat. Lënda kontekstualizon arkitekturën brenda kompleksitetit të të menduarit bashkëkohorë mbi premisat që konstituojnë identitetin e modernës dhe postmodernës si dhe diferencit të vetëdijes njerëzore. Trajtohet segmentimi njohurive përmes diferencimit të shkencave, diferencimit dhe raportit të shkencave humane, përfshirë këtu konceptet themelore të sociologjisë, estetikës dhe filozofisë.
Qëllimet e lëndës:	Ndërlidhja e koncepteve bazë të filozofisë moderne - postmoderne me teorinë arkitekturës, strategjitë e projektimit si dhe metodologjinë e hulumtimit në arkitekturë dhe projektim. Ballafaqime me (a) bazën shkencore të disiplinës, (b) natyrën heuriste të arkitekturës, (c) rolin e sistemeve të organizuara të ideve, në edukimin dhe praktikën arkitektonike, dhe (e) njohuritë në metodat e hulumtimit që dominojnë secilin prej këtyre sistemeve të ideve.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit studenti: <ul style="list-style-type: none"> – identifikon dhe ndërlidh lëvizjet më të rëndësishme filozofike me teorinë dhe projektimin arkitektonik – analizon probleme epistemologjike, perceptuale, estetike dhe etike duke i ndërlidhë ato me tema të veçanta në arkitekturë. – përshkruan konceptet filozofike dhe i zbaton ato në formulime të pozitës personale në lidhje me projektimin dhe rolin e arkitekturës në shoqëri; – formulon pyetje specifike kërkimore që mund të hulumtohen duke përdorur literaturë, si dhe shembuj konkret nga mjedisi i ndërtuar në mënyrë që të formojnë një qëndrim të argumentuar personal në procesin e projektimit.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime dhe punë seminarike. Seria e leksioneve përbëhet nga ligjerata javore. Leksionet fillojnë me një hyrje tematike, pas së cilës diskutohet një "pozicion arkitektonik" i përjavshëm.
Metodat e vlerësimit:	Diskutimet në seminare, prezantimi dhe mbrojtja e punës seminarike.
Literatura primare:	Xhambazi A. (2018). Arkitektura u kontekstu savremenih perspektiva konceptualizacije i materijalizacije. Disertacion i doktoratës, Fakulteti i Arkitekturës Sarajevë Foqué, R. (2010). Building Knowledge in Architecture. Brussels: University Press Antwerp. Groat, L., & Wang, D. (2013). Architectural Research Methods (2nd ed.). New York: John Wiley & Sons Rowe, P. G. (1987). Design Thinking. Cambridge, Massachusetts and London, England: The MIT Press

Literatura shtesë:	<p>Leach, N. (Ed.). (1997). Rethinking Architecture: A Reader in Cultural Theory. London and New York: Routledge.</p> <p>Moore, G. T. (1979). Environment-Behaviour Studies. In J. Snyder, & A. Catanese (Eds.), Introduction to Architecture (pp. 46-71). New York: McGraw-Hill.</p> <p>Johnson, P.-A. (1994). The Theory of Architecture: Concepts, Themes and Practices. New York: John Wiley and Sons.</p> <p>Nesbitt, K. (Ed.). (1996). Theorizing a New Agenda for Architecture: An Anthology of Architectural Theory 1965-1995. New York: Princeton Architectural Press.</p>
---------------------------	---

Titulli i lëndës:	PROJEKTIM 3 – BANIMI I PËRKOHSHËM
Mesimdhësi:	Prof.Ass.Dr. Arta Xhambazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi trajton projektimin e objekteve të banimit të përkohshëm kolektiv.</p> <p>Temat që trajtohen janë si në vijim: projektimi i objekteve të institucioneve parashkollore, konviktet e studentëve, shtëpitë për të moshuar, hotelet, motelet, internatet, etj.</p>
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është njoftimi i studentëve me projektimin, organizimin hapësinor dhe teknologjinë e ndërtimit të objekteve të banimit të përkohshëm kolektiv.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Në fund të kursit studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shqyrton dhe analizon komponentët arkitekturale në vepra arkitekturale të tjera si parakusht për nisjen e veprimtarisë vetanake; – kupton problematikën e organizimit themelor funksional të hapësirave të dedikuara për banim të objekteve turistike; – njeh problematikën e projektimit të përmbajtjeve hoteliere shërbyese në kuadër të objekteve turistike dhe si objekte të veçanta – ka aftësi për projektimin e bllokut të kuzhinës – ka aftësi për projektimin e objekteve të banimit të përkohshëm kolektiv
Metodat e mësimdhënies:	<p>Ligjërimi ex-catedra si dhe diskutimi i temave që ndërlidhen me ligjeratat në mënyrë interaktive me studentë. Ushtrimet zhvillohen përmes detyrave tematike grafike 5 javore që punohen në klasë dhe në shtëpi, si dhe diskutohen në klasë.</p> <p>Detyrat grafike janë detyra individuale.</p>
Metodat e vlerësimit:	Punimet individuale grafike 50%; Kolokuiumi – ushtrimi metodik 1 10%; Kolokuiumi – ushtrimi metodik 2 10%. Provimi me vizatim dhe me shkrim 30%.
Literatura primare:	<p>Walter Kroner, ‘Architecture for children’, Krämer verlag Stuttgart + Zürich, 1994</p> <p>‘Student Housing: the German Experience’, Birkhauser, Basel, Berlin-Boston</p> <p>Fred Lawson, ‘Hotels and Resorts’, Architectural Press, London, 1995</p> <p>Fred L Lawson, ‘Hotels, Motels and Condominiums’, Architectural Press, London, 1976</p>

	<p>Fred L Lawson, 'Restaurant Planning and Design', Architectural Press, London, 1995</p> <p>Fred L Lawson, 'Restaurant, Clubs and Bars', Butterworth-Heinemann, Oxford</p> <p>Eckhard Feddersen and Insa Ludtke, 'Living for the Elderly: A Design Manual', Birkhauser, Basel, 2018</p> <p>AW Architectur + WETTBEBE 197, 'Residences for senior citizens'</p>
Literatura shtesë:	<p>Adler, D., METRIC HANDBOOK – Planning and Design Data (2nd edition), Architectural Press, OXFORD, 2000</p> <p>Baiche, B. Walliman, N., Neufert-Architects' Data (third edition), Oxford, 2000</p> <p>Ramsey / Sleeper, Architectural Graphic Standards, The American Institute of Architects, Ninth Edition, New York, 1994</p> <p>Philip Jodido, 'New Forms – Architecture in 1990', Taschen, The Phaidon Atlas of Contemporary World Architecture</p>

Titulli i lëndës:	PROJEKTIM 4 – NDËRTHESAT KOMERCIALE DHE TREGËTARE
Mesimdhësi:	Prof.Ass. Dr. Arta Xhambazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi Projektim 4: Ndërtesat Komerciale dhe Qendrat Tregtare diskuton dhe studion temën e projektimit të Komplekseve Komerciale dhe Qendrat Tregtare. Kursi zhvillohet një herë në javë dhe është kurs i integruar me pjesëmarrje interaktive të studentëve. Roli kryesor i kursit është të studiojë dhe të hulumtojë tipologjinë e komplekseve multifunkionale bashkëkohore, me theks në tipologjinë: Ndërtesat komerciale me shumë funksione, qendrat tregtare, shtëpitë e mallrave, shitoret e mëdha, mega strukturat për tregëti, tipologjia e strukturave multifunkionale do të caktohet për çdo vit akademik sipas trendeve aktuale në bashkëpunim me studentët dhe referencat ndërkombëtare akademike.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i kursit është të iniciojë, të përdorë parimet themelore të parimeve teorike dhe praktike arkitekturore të projektimit, duke përfshirë ndërlidhjen simbiotike të avancimit të teknologjisë dhe projektimit arkitektonik. Objektivat kryesore të kursit janë subjekt i qasjeve të ndryshme ndërdisiplinore për të zgjidhur problemet e projektimit arkitektonik, duke ndarë proceset krijuese si një qasje për të identifikuar dhe zgjidhur varietetet e problemeve në Arkitekturë. Theksi kryesor i lëndës do të potencojë në zhvillimi e aftësive të studentëve për të studiuar dhe kuptuar ndërlidhjen në mes projektimit arkitektonik, tregëtisë, zhvillimit ekonomik, prodhimeve vendore, zhvillimit urban, mobilitetit, mirëqenjes publike.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit, studentët duhet të kenë kuptuar dhe zotëruar parimet themelore projektuese të komplekseve multifunkionale- Ndërtesat Komerciale dhe Qendrat Tregtare:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë zhvilluar aftësitë dhe teknikat në projektim;

	<ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë zhvilluar aftësitë e nevojshme për projektim e komplekseve multifunkionale me fokus në Ndërtesat Komerciale dhe Qendrat Tregtare; - Studentët kanë zhvilluar aftësi dhe teknika për të përshkruar, analizuar dhe artikulluar procesin e projektimit ndërdisiplinor.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Tematika e shtjelluar në kurs korespondon dhe aktualisht është në vijë me trendet bashkëkohore të mësimdhënjes në universitetet europiane dhe më gjërë. Për më shumë, studentët janë të pajisur me literaturën primare në gjuhën Shqipe falas, nga mësimdhënësi i kursit.
Metodat e mësimdhënies:	Mësimdhënia ka karakterin e diskutimeve interaktive, duke angazhuar në diskutim të gjithë studentët. Gjithashtu, kursi synon që studentët të marrin pjesë në punë grupore, dhe individuale, të cilët do të marrin detyra konkrete në formën e projekteve ideore arkitektonike, dhe vizitave në terren. Ligjëratat, dhe ushtrimet gjatë mësimin në klasë përdorin mjete dhe teknika të ndryshme vizuale, kurse gjatë punës me studentë në konsultimet individuale promovohet dhe vlerësohet puna e pavarur.
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë për kursin: <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e studentit në ligjerata dhe ushtrime, aktiviteti 10% - Vlerësimi obligativ intermediar - Fazat 10% - Portfolio e punimeve grafike, detyrave, seminareve, të vlerësuar me notë pozitive gjatë semestrit, janë kusht për të marrur ECTS – si dhe janë kusht për t’iu nënshtruar provimit përfundimtar 50% - Provimi përfundimtar, Test me shkrim 30%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 3. Bujar Bajçinovci, Sustainable Architectural Design – principles, in the Albanian Language, 4 (3), JOSHA, 2017. DOI: 10.17160/josha.4.3.306 4. Bujar Bajçinovci, Commercial Hybrid Buildings - Planning and Design, in Albanian Language 4 (3), JOSHA, Germany. 2017. DOI: 10.17160/josha.4.3.309
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 4. Yeal Xie. Shopping Malls. (2011). Design Media Publishing Ltd. 5. Carles Broto. New Shopping Malls (2007). Links International. 6. David Smiley. Pedestrian Modern, Shopping & American Architecture. (2013). Mpress.

Titulli i lëndës:	URBANIZMI 1
Mesimdhënesi:	Dr.Sc. Ilir Gjinolli
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Qyteti dhe urbanizmi, konteksti i dizajnit urban, hapësira publike dhe private si bazë për principet e dizajnit urban. Kuptimi i profesionit dhe konteksti në të cilin veprojnë urbanistët.

	Ndryshimet urbane dhe dimensionet e dizajnit urban. Kuptimet themelore teorike të dizajnit të hapësirës urbane– dimensionimi morfologjik, social/kulturor, perceptual vizual, funksional dhe temporal. Hapësira Publike, konceptet, kategorizimi dhe kualitetet e hapësirës publike
Qëllimet e lëndës:	T'u mundësojë studentëve kuptuarjen e koncepteve themelore të dizajnit urban përmes mësimit teorik dhe analizës së fenomeneve urbane brenda një konteksti social, ekonomik dhe mjedisor.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Përmes njohurive teorike dhe hulumtimit të problemeve konkrete në qytetet e Kosovës: <ul style="list-style-type: none"> • Do të përvetësojnë konceptet themelore të dizajnit urban dhe kontekstin në të cilin ai zhvillohet • Përvetësimi i njohurive dhe shkathtësive në hulumtimin e hapësirës urbane. • Kuptuarja e hapësirës publike dhe peizazhi urban, dimensionet fizik dhe social
Metodat e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjeratë dhe diskutimi në fund të çdo moduli, • Projekti hulumtues - punë grupore dhe seminari hulumtues - punë individuale
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Projekti hulumtues dhe Seminari hulumtues 50% • Provimi final 40% • Vijimi i rregullt 10%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1.Carmona, Heath, Oc, Tiesdell: Public Places, Urban Spaces, The dimensions of Urban Design, Architectural Press, First Edition 2005 2.Jan Gehl: Life between Buildings, Arkitektens Forlag,1970 Fourth Edition 2001 3.Kevin Lynch: The Image of a City, MIT Press, Edition 1974, Fourth Edition 2001 4.Jane Jacobs: The Death and Life of great American Cities, Pimlico 1961
Literatura shtesë:	1.Carmona, Tiesdell: Urban Design Reader, Architectural Press, First Edition 2007

Titulli i lëndës:	ARKITEKTURA MODERNE DHE TRENDET BASHKEKOHORE
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Teuta Jashari Kajtazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Lënda përmban llojllojshmërinë dhe karakterin pluralist të zhvillimit të arkitekturës prej fillimit të shekullit 20 (1900) e deri tek ajo e kohës sonë, marrëdhëniet në mes të qenies njerëzore dhe prodhimit hapësinor modern dhe bashkekohor
Qëllimet e lëndës:	Përmes prerjeve të ndryshme tipologjike, lëvizjeve, masave, teksteve dhe traktateve, personaliteteve dhe tërësive të arkitekturës i ofron studentit njohjen e tërë shtresimit të teorisë dhe praktikës arkitektonike gjatë shekullit

	20 dhe në ditët e sotme, me çfarë punën dhe përpjekjen e tij e bën me komplekse dhe më të pasur
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Njohuri mbi rrethanat shoqërore, ekonomike e tjera, të cilat ndikuan dhe ndikojnë në lindjen dhe zhvillimin e arkitekturës në shtetet e ndryshme evropiane dhe botërore, ndikimet reciproke në arkitekturë, veprimtarinë e arkitektëve të mëdhenj të cilët përfaqësojnë lëvizjet në arkitekturën e epokave të mëdha artistike, si në vazhdim: Shkolla e Chicago-s, Lëvizjet kthesë në Art dhe Arkitekturë, Arkitektura Organike dhe Frank Lloyd Wright, Walter Gropius dhe Bauhaus, Le Corbusier, Mies Van Der Rohe, Alvar Alto, Metabolizmi Japonez, Robert Venturi, Modernizmi, Norman Foster, Renzo Piano, Richard Rogers, Qyteti Postmodern: Richard Meyer, Michael Graves, Rob Krier, Frank O. Gehry si dhe Trendet/ zhvillimet aktuale në Arkitekturë. Në kontekst të veçant do të përmenden zhvillimet më të rëndësishme në Arkitekturën moderne në Kosovë.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata tematike, analiza e shembujve praktik nëpërmes projeksioneve vizuale Ushtrimet: Seminar me tema të arkitekturës bashkëkohore, gjegjësisht, prej vitit 1900 e deri në ditët e sotme.Konsultimet
Metodat e vlerësimit:	Detyra semestrare / Ese/ seminari/prezentimi 50% Vijimi i rregullt 10% Testet semestrare (2) 40% (apo provimi) Totali 100%
Literatura primare:	<i>T. Jashari-Kajtazi</i> : Ligjëratat në trajtë dispense/ me prezantime të bashkangjitura (ne forme elektronike) <i>T.Jashari-Kajtazi, A.Jakupi</i> : Interpretation of architecture lidentity through landmark architecture: The case of Prishtina, Kosovo from the 1970s to the1980s, Frontiers of Architectural research. https://teutajasharikajtazi.wordpress.com <i>T.Jashari-Kajtazi</i> : Architectural interpretation of the National and University Library in Prishtina; the influence in its surroundings, International Journal for Engineering and Information Sciences, Pollack periodica. https://teutajasharikajtazi.wordpress.com <i>William J. Curtis</i> : Modern Architecture since 1900, 1996 <i>Gossel, Leuthause</i> : Architecture in the twentieth Century, 2005 <i>Le Corbusier</i> : Drejt një arkitekture, 2013 <i>Luca Molinari</i> : Architecture Movements and Trends from the 19th Century to the Present, 2015
Literatura shitesë:	<i>M. Moffett, M. Fazio, L. Wodenhouse</i> : A World History of Architecture, 2003 <i>Xhambazi, A.</i> (2016). Transformation of Theory and Practice: Shaping Strategies of Contemporary Architecture. International Journal of Contemporary Architecture ”The New ARCH“, 3(1), 25-38. http://the-new-arch.net/Articles/v03n01a04----Arta-Xhambazi.pdf

Titulli i lëndës:	FIZIKA E NDERTIMIT
Mesimdhënesi:	Xhelal Lloncari, IDA

Statusi i lendes:	Obligative
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Njohuritë themelore të termodinamikës; energjia, nxehtësia, temperatura, transmetimit i energjisë (nxehtësisë); Difuzioni i avullit të ujit, madhësitë dhe njësitë themelore, njehsimi i difuzionit të au, pengesa ndaj avullit të ujit, rekomandimet dhe rregulloret përkatëse; Zhurma dhe burimet e saj, paraqitja dhe parandalimi i zhurmës, lakoret standarde të saj, rekomandimet dhe rregulloret përkatëse; Akustika arkitektonike: zëri dhe valët zanore, rezonanca, interferenca, efekti i Doppler-it, karakteristikat e burimit të zërit, fenomene të cilat shoqërojnë përhapjen e zërit; Akustika e hapsirave të ndryshme, jehona, absorberët zanorë dhe llojet e tyre.
Qëllimet e lëndës:	Shpjegimi i fizikës arkitektonike si komponentë shkencore në arkitekturë; Të njoftojë studentët me konceptet themelore dhe format e komfortit, nga aspekti i fenomeneve fizike, të cilave i është ekspozuar ndërtesa; Të nxisë studentët në kërkime të mëtejshme të zgjidhjeve në arkitekturë e vecanërisht, në aspektin e materializimit të hapsirave.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	1) Studenti duhet të jetë në gjendje për të parë arkitekturën si një unitet në mes të kompenatës së saj artistike dhe empirike. 2) në mënyrë konkrete të verifikojë njohuritë e zëna duke analizuar kushtet e komfortit në projektin e tij, si në mënyrë analitike poashtu dhe atë grafike. 3) Llogaritja e parametrave fizikë të përmendur më lartë me softwer – in Novoterm.exe.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata të formës “Ex Cathedra” të shoqëruara me forma të ndryshme të mësimdhënies interaktive (ndërrhyrje dhe prezentime nga studentët , punimi seminarik, konsultime
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë 30%, Vlerësimi i dytë 25%, Detyrat e shtëpisë 10%, Vijimi i rregullt 5%, Provimi final 30%.
Literatura primare:	Ekstrakt i mësimdhënësit për çdo njësi mësimore. Carl Eric- HAGENTOFT , “Introduction to Building Physics”, 2011;
Literatura shtesë:	Hens HUGO, “Building Physics – Heat, Air and Moist”, Ernst & Sohn, Wiley Company, Germany, 2007

Titulli i lëndës:	STRUKTURAT HAPESINORE
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Fatos Pllana
Statusi i lendes:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lende trajton strukturat hapsinore te formave te ndryshme.Trajtohen strukturat prej atyre me te thjeshta siq jane strukturat me mbatesa vijore deri te strukturat qe mund te jene me forme te qfardoshme
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i ketij kursi eshte qe studenti te aftesohet per pervesimin e struktures adekuate mbaresisht prej problemit i cili i parashtrohet ne funksion te kerkesave dhe kushteve te cilat i ipen. Të bëjë perpilimin e elaborateve ku eshte i permblodhur planprogrami i ligjeratave. Të jetë i pregaditur dhe i aftë për ndjekjen e studimeve vijuese të nivelit Master.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Te kuptojnë strukturat hapësionale prej atyre me te thjeshta deri te strukturat e llojeve me te perbera te formave te ndryshme. Ne baze te kuptimit te pikave te meparshem te jete ne gjendje te beje nje analize complete per strukturat hapësinore.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Rëndësia e kesaj lende eshte qe studentit te fomohet per te menduar struktura sa me atraktive me materialet gjegjese te cilat eksistojnene ate vend ku ndertohet.
Metodat e mësimdhënies:	Medoda e mesimdhënjes eshte kryesisht me projektor por perdoret edhe shkumesi.
Metodat e vlerësimit:	Pjesa teorike 60% , pjesa me shkrim 40%
Literatura primare:	Strukturat hapësinore” dispence, Fatos Pllana, Ligjerata te autorizuar
Literatura shitesë:	“Teoria e sistemeve siperfaqesore”, prof.dr.Musa Stavileci “Lake metalne konstrukcije”, Vlladimir Georgijevski “Konstruktionet prej druri”, prof.Zeqir Rugova

Titulli i lëndës:	NDËRTIMI MONTAZH
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Florim Grajcevci
Statusi i lendes:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Një lëndë teorike e lidhur me zbërthime dhe shembuj nga praktika ndryshe nga ndërtimi tradicional. Ndërtimi modern, i shpejtë, ekonomik dhe cilësor i objekteve. Dizajni konceptual i elementeve të përgatitura. Materielet e mundura për përdorim të ndërtimit të elementeve të objekteve. Ndërtimi me elemente të parapërgatitura si fushë e efqiencës së energjisë. Konceptet e ndërtimit të strukturave dhe objekteve të përgatitura nga betoni, çeliku, druri etj. Projektimi i detaleve lidhëse të elementeve të parapërgatitura.
Qëllimet e lëndës:	Një modul teorik që aftëson studentin me njohurit elementare të ndërtimit të elementeve të parapërgatitura për objektet. Krijimi i njohurive lidhur me rritjen e shpejtësisë së ndërtimit, sigurimit të cilësisë së ndërtimit dhe industrializimin e ndërtimit të objekteve. Projektimi i objekteve me elementet të parapërgatitura nga materiali beton i armuar, arsyetimi profesional i përdorimit të ndërtimit industrial – në fabrika. Kategoritë e objekteve ku mund të përdoren ndërtimet montazhe.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Radhit dhe shpjegon përparësitë teknike dhe të metat e ndërtimit të parafabrikuar. • Shpjegon efektet kohore, financiare dhe ekologjike në përdorimin e ndërtimit montazh. • Projekton elemente të parapërgatitura nga materialet e ndryshme ndërtimore (betoni, çeliku, druri etj). • Analizon mundësinë e përdorimit të ndërtimit montazh te objektet e veçanta.

	<ul style="list-style-type: none"> • Vizaton detaje të lidhjeve të elementeve të gatshme nga materiale të ndryshme. • Përcakton përdorimin e materialeve ndërtimore që i përgjigjen kushteve të përgjithshme të vendndodhjes së objektit gjatë projektimit të objekteve montazhe. • Përshkruan elementet e parapërgatitura nga betoni i armuar, lidhjet e tyre ndërmjet veti dhe funksionalizimin e objektit
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Për studentet e arkitekturës dhe arkitektet e rinj, kjo lëndë është e një rëndësie te veçantë për shkak se u ndihmon të kuptojnë që përpos dizajnit të një objekti të çfarëdo funksionit qoftë ai, nevojitet një kontingjent i tërë i aftësive, kreativitetit dhe përkushtimit nga njerëz të tjerë profesionist e mjeshtrë për t'i realizuar në praktikë veprat e tyre. Për më tepër, duke qenë se profesionet gjithnjë e më tepër janë duke u shkrirë dhe ri-formësuar dhe janë në transformim të pandalshëm, sipas nevojave që paraqiten në praktikë dhe në kërkim të efikasitetit maksimal të proceseve, arkitektet duhet të kuptojnë qartë zhvillimin e të gjitha fazave të realizimit të veprave të tyre. Ata duhet të jenë monitorues, këshillues dhe të përfshirë përgjatë tërë procesit për ta finalizuar idenë e tyre ashtu siç ata e kanë vendosur paraprakisht në letër.
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi do e realizohet përmes ligjëratave, ushtrimeve, detyrave në grupe, vizitave në punishte.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit 10%; Detyrat individuale të kryera në klasë 15%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 15%; Vlerësimi nga testet 60%; Provimi final 100%.
Literatura primare:	Ligjëratat e përgatitura nga profesori i lëndës
Literatura shtesë:	Eurocode – Basis of structural design, Final draft, prEN 1990, 2001 - Eurocode 1; Action on structures Part 1-1: General actions – Densities, self-weight, imposed loads for buildings, Final draft, prEN 1991-1-1, 2001. - Eurocode 1; Action on structures Part 1-3: General actions – Snow loads, prEN 1991-1-3, 2003. - Eduard R Sturm, A Fattah Shaikh, Design and Typical Details / of Connections for precast and prestressed Concrete - BCA Buildability Series, “Architecture in Precast Concrete” - Guide to good practice, “Structural Connections for precast concrete”
Titulli i lëndës:	SOCIOLOGJIA URBANE
Mesimdhënesi:	Dr.Sc. Ilir Gjinolli
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4

Përshkrimi i lëndës:	Ekzistenca urbane është fati I rritjes së vazhdueshme të popullësisë në botën moderne. Në fillimet e shekullit të 21-të - 3 bilion njerëz jetojnë në zonat urbane dhe deri në vitin 2030 parashihet që popullësia urbane të arrijë në 5 bilion. Poashtu është e evidente që regjionet metropolitane të vendeve të zhvilluara do të ballafaqohen me kështu lloj rritje. Rritja e qytetit modern në periudhën post industriale ka ngritur pyetje të reja intelektuale dhe detyra që sociologjia urbane mund të adresojë dhe të gjejë përgjigje. Lënda do të mundësojë studentëve që t'i vlerësojnë zhvillimet urbane nga perspektiva sociologjike, poashtu marrëdhëniet rurale-urbane, teknologjitë e reja në zhvillimet urbane, etj
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi është që të krahasohen dhe ballafaqohen casjet e ndryshme teorike dhe metodologjike për kuptuarjen e jetes urbane
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Kuptuarja e ndërvaresisë së formës urbane me dinamikën shoqërore në prizmen e urbanizimit, industrializimit dhe modernizimit. Me këtë rast zhvillimi i mendimit kritik dhe interpretimit të fenomeneve urbane nga ana e studentëve është qëllim në vetvete.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata tematike, Ushtrimet: Seminar hulumtues me tema mbi ndikimet shoqërore në zhvillimet urbane Prezentimet/diskutimet
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi formativ dhe përmbljedhës. Detyra semestrale / Ese/ seminari/prezentimi 60% Testet semestrale (2) 40% (apo provimi) Totali 100%
Literatura primare:	1. Gottdiener, Mark and Ray Hutchison (2006) <i>The New Urban Sociology</i> . Boulder: West View Press. 2. Gottdiener, Mark and Leslie Budd (2005) <i>Key Concepts in Urban Studies</i> . London: Sage Publications. 3. Lin Jan and Mele Christopher, ed. (2005) <i>The Urban Sociology Reader</i> . London: Routledge 4. Zukin, Sharon, 1995. <i>The Cultures of Cities</i> , London: Blackwell 5. James L. Spates et al. 1982. <i>The Sociology of Cities</i> , New York: St' Martin's Press
Literatura shtesë:	1. Wirth, Louis 1991. <i>Urbanism a Way of Life</i> , Irvington Publications 2. Harvey, David, 1989. <i>The Urban Experience</i> , Baltimore: John Hopkins Press 3. Castells Manuel and A. Sheridan, 1977. <i>The Urban Question</i> , London: Edward Arnold 5. <i>The City Cultures Reader</i> , Borden & Hall, eds. 6. <i>The Urban Ethnography Reader</i> . New York: Oxford University Press. 7. Knox, Paul-Pinch, Steven, <i>Urban Social Geography, An Introduction</i> , Prentice Hall 8. Low Setha and Smith Neil – <i>The Politics of Public Spaces</i> ,

Titulli i lëndës:	ARKITEKTURA E PEISAZHIT
Mesimdhësi:	Prof.Ass.Dr. Dukagjin Hasimja
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	<p>Çka është arkitektura peizazhore .Arkitektët e pare peizazhist dhe ndikimi I tyre në historinë e arkitektuës së peizazhit. Arkitektura peizazhore moderne, dizajni ekologjik dhe estetika e qëndrueshmërisë.</p> <p>Peizazhi- paterna, përcëptimi dhe procesi. Elementet e dizajnit visual në peizazh. Forma, kuptimi dhe eksperiencia Prosesi I dizajnit dhe roli I concept idesë.</p> <p>Grafika e peizazhit dhe sofverët në arkitekturën e peizazhit.</p>
Qëllimet e lëndës:	Njohja teorike dhe kuptuarja e arkitekturës së peizazhit si dhe procesi I dizjanit permes zhvillimit të një projekti.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Njohja me kontribuesit kulturor të arkitekturës peizazhore • Njohja me teorinë dhe zhvillimi I mendimit kritik lidhur me çështje të arkitekturës së peizazhit. • Kuptuarja e elementeve bazike, variablave, organizimi dhe gjuha e arkitekturës peizazhore • Përvetësimi I koncepteve themelore <p>Mjetet e punës dhe softverët në arkitekturën e peizazhit</p>
Metodat e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjeratë dhe diskutimi në fund të cdo moduli, • Projekti hulumtues–punë grupore dhe seminari hulumtues– dhe punë individuale
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Projekti hulumtues dhe seminari hulumtues 50% • Provimi final 40% • Vijimi i rregullt 10%
Literatura primare:	<p>1.Simon,Swaffield. (2002) Theory in Landscape Architecture: A Reader, (Philadelphia: University of Pennsylvania Press</p> <p>2.Spirn, Anne, “The Language of Landscape,” in Theory in Landscape Architecture: A Reader (Philadelphia: University of Pennsylvania Press, 2002)</p> <p>3.Bell,Simon, “Landscape- pattern, perception and process,” (London: E&FN SPON, 1999)</p>
Literatura shitesë:	<i>I_Bell,Simon, “Elements of visual design in the landscape,” (London: SPON, 2004)</i>

Titulli i lëndës:	PROJEKTIM - QENDRAT E KOMUNITETIT
Mesimdhësi:	Prof.Asoc.Dr. Vlora Navakazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Arkitektura e komunitetit nënkupton një mjedis të ndërtuar që i ofrohet komunitetit, përfiton ose stimulon pjesëmarrjen e komunitetit në një kuptim

	<p>thellësisht social dhe gjithëpërfshirës. Këto janë ndërtesa të përhershme dhe të përkohshme në nivel të qytetit - hapësira publike, sheshe, panaire dhe objekte arkitekturore të komunitetit/bashkësive. Është e zakonshme të shohësh se qendrat e komunitetit përdoren në pjesë të ndryshme të botës. Ata kanë përmbushur role të ndryshme në shumë komunitete për shumë qëllime si institucione sociale, institucione jashtëshkollore, qendra komunitare, pavijone ekspozuese dhe tw panaireve, objektet sakrale, varreza, qendra gerontologjike, sanatorium, krematoriumet dhe komplekset memoriale. Në ditët e sotme, qendrat e komunitetit janë përmbajtje të nevojshme, të cilat marrin parasysh nevojat e të gjitha grupmohave në komunitet, mjedisin, qëllimin e ndërtimit dhe qëndrueshmërinë.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i këtij kursi është të njoftojë studentët me rëndësinë dhe karakteristikat e procesit të integruar të dizajnit në krahasim me problematikat e përzgjedhjes së llojit të qendrës së komunitetit.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Njoh rëndësinë e projektimit të ndërtesave të komunitetit; - Zhvilloj qasje hulumtuese dhe kërkimore; - Integroj dhe prezantoj njohuritë e fituara; - Hulumtoj dhe shfrytëzoj materiale dhe teknologji tradicionale dhe bashkëkohore në projektimin arkitektonik; - Zhvilloj qasje kreative në përdorimin dhe zgjidhjen e teknologjive konstruktive dhe aplikimi i tyre;
Metodat e mësimdhënies:	<p>Ligjerata, mënyra multimediale e prezentimit, komentim analitik dhe krahasimi; ushtrimet e organizuara me punë në grupe; hulumtime dhe vizita në teren, detyra individuale nën mbikëqyrje.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Me dorëzimin dhe vlerësimin pozitiv të punimit individual/grupor, studenti fiton të drejtën e nënshkrimit. Kriteret e vlerësimit dhe kalueshmërisë në : Prezenca në ligjerata dhe aktiviteti në ushtrime (10%), eseu (15%), Kolokiumi (15%); projekti Individual/grupor (2-3 studentë) (55%); Provimi përfundimtar (5%).</p>
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Purini, F., Competition Ideas for the Italian Pavilion at Expo Shanghai 2010: The Future of Cities is "Made in Italy", ISBN-10: 8849219342, ISBN-13: 978-8849219340. Publisher: Gangemi Editore (December 3, 2010). 2. Stegers, R., SACRED BUILDINGS (Design Manuals), ISBN-10: 3764366834, ISBN-13: 978-3764366834. Publisher: Birkhäuser Architecture; 1 edition (May 16, 2008). 3. Arnold, E., Why we live in community, 2011, New York, Plough Publishing House Rifton; 4. Designing A Complete Community Center: Responsive Design in a Rural Setting; SIT Graduate Institute/SIT Study Abroad, Spring 5-2012, https://digitalcollections.sit.edu/cgi/viewcontent.cgi?referer=https://www.google.com/&httpsredir=1&article=3561&context=capstones
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 5. Progressive Community Design, PROGRESSIVE PLANNING, The Magazine of Planners Network, http://www.plannersnetwork.org/

	6. COMMUNITY CENTRE MINIMUM SPECIFICATIONS ; https://artistscoalition.files.wordpress.com/2012/09/final-community-centre-document.pdf
--	---

Titulli i lëndës:	PROJEKTIM ARKITEKTONIK – DATA QENDRAT DHE TERMINALET DISTRIBUIVE
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Arta Xhambazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Kursi Projektim Arkitektonik: Data Qendrat dhe Termialet Distribuive diskuton dhe studion temën e projektimit të Komplekseve multifunkionale. Kursi zhvillohet një herë në javë dhe është kurs i integruar me pjesëmarrje interaktive të studentëve. Roli kryesor i kursit është të studiojë dhe të hulumtojë tipologjinë e komplekseve: Qendrat e të dhënave, IT qendrat, termialet distribuive, termialet doganore, qendrat telekomunikuese, termialet e infrastruktures digjitale, mega strukturat dhe komplekset të TI, tipologjinë e strukturave multifunkionale do të caktohen për çdo vit akademik sipas trendeve aktuale në bashkëpunim me studentët dhe referencat ndërkombëtare akademike.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është të inicijojë, të përdorë parimet themelore të parimeve teorike dhe praktike arkitekturore të projektimit, duke përfshirë ndërlidhjen simbiotike të avancimit të teknologjisë dhe projektimit arkitektonik. Objektivat kryesore të kursit janë subjekt i qasjeve të ndryshme ndërdisiplinore për të zgjidhur problemet e projektimit arkitektonik, duke ndarë proceset krijuese si një qasje për të identifikuar dhe zgjidhur varietetet e problemeve në Arkitekturë. Theksi kryesor i lëndës do të potencojë në zhvillimi e aftësive të studentëve për të studiuar dhe kuptuar ndërlidhjen në mes projektimit arkitektonik, qendrat e të dhënave, IT qendrave, qendrat telekomunikuese, termialet e infrastruktures digjitale.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studentët duhet të kenë kuptuar dhe zotëruar parimet themelore projektuese të komplekseve multifunkionale- Data Qendrave dhe Termialet Distribuive : <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë zhvilluar aftësitë dhe teknikat në projektim; - Studentët kanë zhvilluar aftësitë e nevojshme për projektim e komplekseve multifunkionale me fokus në Data Qendrat dhe Termialet Distribuive ; - Studentët kanë zhvilluar aftësi dhe teknika për të përshkruar, analizuar dhe artikulluar procesin e projektimit ndërdisiplinor.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Tematika e shtjelluar në kurs koresponon dhe aktualisht është në vijë me trendet bashkëkohore të mësimdhënjes në universitetet europiane dhe më gjërë. Për më shumë, studentët janë të pajisur me literaturën primare në gjuhën Shqipe falas, nga mësimdhënësi i kursit.
Metodat e mësimdhënies:	Mësimdhënia ka karakterin e diskutimeve interaktive, duke angazhuar në diskutim të gjithë studentët. Gjithashtu, kursi synon që studentët të marrin pjesë në punë grupore, dhe individuale, të cilët do të marrin detyra konkrete në

	formën e projekteve ideore arkitektonike, dhe vizitave në terren. Ligjëratat, dhe ushtrimet gjatë mësimit në klasë përdorin mjete dhe teknika të ndryshme vizuale, kurse gjatë punës me studentë në konsultimet individuale promovohet dhe vlerësohet puna e pavarur.
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë për kursin: <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e studentit në ligjerata dhe ushtrime, aktiviteti 10% - Vlerësimi obligativ intermediar - Fazat 10% - Portfolio e punimeve grafike, detyrave, seminareve, të vlerësuar me notë pozitive gjatë semestrit, janë kusht për të marrur ECTS – si dhe janë kusht për t’iu nënshtruar provimit përfundimtar 50% - Provimi përfundimtar, Test me shkrim 30%
Literatura primare:	<p>5. Bujar Bajçinovci, Sustainable Architectural Design – principles, in the Albanian Language, 4 (3), JOSHA, 2017. DOI: 10.17160/josha.4.3.306</p> <p>6. Bujar Bajçinovci, Commercial Hybrid Buildings - Planning and Design, in Albanian Language 4 (3), JOSHA, Germany. 2017. DOI: 10.17160/josha.4.3.309</p>
Literatura shtesë:	<p>7. Yeal Xie. Shopping Malls. (2011). Design Media Publishing Ltd.</p> <p>8. Carles Broto. New Shopping Malls (2007). Links International.</p> <p>9. David Smiley. Pedestrian Modern, Shopping & American Architecture. (2013). Mpress.</p>

Titulli i lëndës:	FENOMENOLOGJIA DHE ARKITEKTURA
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Astrit Salihu
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Kursi është konceptuar që të mundësojë studentët që ta shohin arkitekturën të shtruar në interpretimin fenomenologjik. Me kthesën fenomenologjike hapen aspekte të reja të të kuptuarit të hapësirës mbi premisat e qenësimit të njeriut, strukturës së tij ekzistenciale në hapësirat që trajtimi abstrakt dhe gjeometrik i ka boshatisur dhe i ka zhveshur nga përjetimi njerëzor. Për kthesën fenomenologjike në arkitekturë është e udhës ta përdorim formulimin e Gaston Bachelard si poetik e hapësirës, ngase edhe Heidegger banimin e shëh si banim poetik. Ky kurs për shkak të kompleksitetit të teorive fenomenologjike visa-vi arkitekturës do të fokusohet në tre autorë: Gaston Bachelard, Martin Heidegger, Christian Norberg-Schulz
Qëllimet e lëndës:	Njohja e problematikës fenomenologjike në raport me arkitekturën
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> – arrijë të eksplikoj konceptet fundamentale rreth hapësirës dhe banimit nga prizmi fenomenologjik;

	– informoj për kontekstin më të gjerë të shprehjes fenomenologjike në arkitekturë
Metodat e mësimdhënies:	Ligjeratë e avansuar dhe diskutime, detyrë shtëpie grupore dhe individuale.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%. Vijueshmëria e studentit 10%; Angazhimet në ushtrime 15%; Vlerësimi nga testet 30%; Provimi final 45%.
Literatura primare:	Astrit Salihu, Lexim Filozofik i Arkitekturës, SHFK/Prishtinë, 2018 Gaston Bachelard, Poetics of Space, Bacon Press, Boston, 1994 Adam Sharr, Heidegger for Architects, Routledge/London-New York, 2007 Christian Norberg Schulz, Genius Loci, Towards a Phenomenology of Architecture/ Rizzoli, 1980
Literatura shtesë:	Martin Heidegger, Leksione dhe Konferenca, Plejd/Tiranë, 2003 Jeff Malpas Heidegger's Topology, Being, Place, World, MIT Press, 2006 Miguel de Bistegui, Thinking with Heidegger, Displacements, Indiana University Press, 2003 Christian Norberg Schulz, Existence, Space and Architecture, Preager, New York, 1974 Gaston Bachelard, Water and Dreams (An Essay of Imagination of Matter), Dallas, The Pegasus Foundation, 1999

Titulli i lëndës:	REGJIONALIZMI NE ARKITEKTURE
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Teuta Jashari Kajtazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Lenda ne parim trajton pershkrimin e karakterisitikave te arkitektures regjionale ne pergjithesi, interpretimit historik, karateristikave te arkitektures regjionale ne Kosove, duke u perqendruar ne periudhen e Modernes se Shekullit 20-te, moment ky i cili ka te beje me regjionalizimin modern dhe karakteristikat e te njejt
Qëllimet e lëndës:	Familjarizimi me regjionalizmin si koncept ne arkitekture, regjionalizmin modern dhe ate kritik si dhe bio-regjionalizmin si nje nga lidhjet e mundshme te krijuara me ekoarkitekturen dhe qendrueshmerine ne ambient.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Do te ofrohen mundesite e njohjes me te thelluar te arkitektures regjionale ne kontekst kohor te lidhur me Modernen dhe regjionalizmin modern, te cilet poashtu nuk mund te shkeputen nga karakteristikat e identitetit regjional dhe regjionalizmit kritik. Ne kete menyre do te kompletohet informimi ne lidhje me karakteristikat e arkitektures moderne, duke iu referuar specifikave arkitekture te regjionit gjate gjithe kohes
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata/ Leksione teorike dhe praktike Obligimet semestrale te studenteve jane si ne vijim: - Pune grupore (tre pjesemarres me se shumti)

	- Detyra semestrare perfshine hulumtim, casje teorike dhe interpretative te autoreve te ndryshem me pikepamje regjionaliste ne arkitekture, karakteristikat dhe veprat te cilat me se miri paraqesin kete.
Metodat e vlerësimit:	Detyra semestrare_50% Prezentimet semestrare_40% Vijimi i rregullt dhe aktiviteti_10% Totali_100% - Sic shihet me larte, vleresimi ne lende behet nepermes suksesit te arritur ne detyre semestrare dhe prezentimeve te lidhura me detyren, te cilat do te behen tre here gjate semestrit (duke e percjellur keshtu ecurine e punimit)
Literatura primare:	<i>Vincent B. Canizaro</i> , Architectural regionalism; Collected writings on place, Identity, Modernity, and Tradition, (Princeton architectural press, New York), 2012 <i>Kenneth Frampton</i> , Modern Architecture; a critical history, (Thames & Hudson, New York), 2007 <i>Teuta Jashari-Kajtazi</i> , <i>Arta Jakupi</i> , Interpretation of architectural identity through landmark architecture: the case of Prishtina, Kosovo from the 1970s to the 1980s (Frontiers of Architectural Research, Science Direct) (https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S2095263517300560) <i>Teuta Jashari-Kajtazi</i> , Architectural interpretation of the National and University library in Prishtina; the influence in its surroundings (Pollack periodica, Academiai Kiado) https://teutajasharikajtazi.files.wordpress.com/2017/03/doi_10-1556_606_2017_12_1_14.pdf
Literatura shitesë:	<i>Liane Lefaivre</i> , <i>Alexander Tzonis</i> , Critical regionalism: architecture and identity in a globalized world, 2003

Titulli i lëndës:	ARTI, KULTURA DHE TEKNOLOGJIA
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Arta Basha Jakupi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Kursi në Art, Kulturë dhe Teknologji funksionon si një studim kritik dhe laborator me bazë prodhimi, që lidh artet me një komunitet të avancuar teknologjik. Ky kurs thekson eksperimentimin dhe qasjet ndërdisiplinore për prodhimin e studios në median tradicionale dhe ato të reja. Studentët angazhohen në studime dhe hulumtime të avancuara vizuele duke zbatuar një qasje eksperimentale dhe sistematike në prodhimin kreativ dhe bashkëpunimin
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs ka një fokus të fortë në dialogun në art, arkitekturë, urbanizëm dhe në prodhimin e hapësirës; ndërhyrjet në hapësirat publike dhe zhvillimin e anti-monumenteve dhe instrumenteve të reja të kujtesës kolektive; dizajn interrogativ, ndërfaqet midis praktikave të artit vizual, performativës dhe zërit; dhe Arti dhe Shkenca / Shkenca dhe praktikat artistike të bazuara në kërkimin e artit. Studentet inkurajohen të marrin si kontekstin fizik ashtu edhe

	atë kulturor të punës së tyre si elementë qendrorë të interpretimeve të tyre. Prezantimet në artin bashkëkohor, diskutimet në teori dhe kritika, si dhe një kuptim i praktikës artistike të bazuar në hulumtime plotësojnë prodhimin e studios dhe zhvillimin e projekteve.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	- të mendojnë në mënyrë kritike dhe kreative -zhvillojnë aftësinë për të eksploruar dhe marrë në pyetje kryqëzimin e kulturës, artit dhe teknologjisë -të jenë në gjendje të identifikojnë dhe të mendojnë për retorikën publike, komunikimin praktik. - të tregojnë aftësi për të aplikuar arsimin e tyre në botën e vërtetë dhe në bazë të komunitetit - të tregojnë një fokus të fortë në dialogun në art, arkitekturë, urbanizëm dhe në prodhimin e hapësirës
Metodat e mësimdhënies:	Klasat do të kombinojnë leksione interaktive, shfaqje filmike, diskutim, punë në terren, analizë të rasteve studimore, punë seminare dhe punë studimore. Çdo klasë ka një sërë leximi, dhe është e rëndësishme që studentët të vazhdojnë me leximet dhe të jenë të përgatitur për t'i diskutuar ato në klasë. Hulumtimi zhvillohet në grupe tematike, ndërsa projekti është individual ose në grupe.
Metodat e vlerësimit:	Prezenca e studentit 5%; Vlerësimi i Parë 35%; Vlerësimi i dytë 35%; Puna individuale 25%, provimi përfundimtar për ata që nuk kanë kaluar vlerësimin e parë dhe të dytë.
Literatura primare:	Macmillan P., (2002) Culture and Technology, Palgrave Macmillan Freeland C., (2002) But is it art?, Oxford University Press
Literatura shtesë:	Greenberg C., (1971) Art and Culture: Critical Essays, Beacon Press Mackenzie A., (2006) Transductions: Bodies and Machines at Speed, Continuum Gerish S., & Scott K., (2018) How Smart Machines Think, The MIT Press Greefield A., (2018) Radical Technologies: The Design of Everyday Life, Verso

Titulli i lëndës:	HAPËSIRA, FUQIA DHE REPREZENTIMI
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Vjollca Krasniqi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Hapësira prodhohet, ndërtohet, dhe transformohet përmes intervenimeve të drejtpërdrejta dhe të planifikuara por edhe përmes veprimeve jo të koordinuara, përgjatë konteksteve historike dhe strukturore. Për më shumë, hapësira si konditë dhe veprim (Lefebvre) përshkohet nga fuqia, sistemet politike, dhe kultura. Kjo lëndë fokusohet në teoretizimet dhe ndërlidhjet në mes të hapësirës, fuqisë dhe reprezentimit. Lënda shqyrton pyetje qendrore rreth prodhimit të hapësirës, përvojës së jetuar, dhe reprezentimit dhe duke aplikuar analiza të informuara historike përgjatë gjeografive të ndryshme shoqërore për të kuptuar se si shoqëria, fuqia dhe kultura ndërveprojnë në prodhimin hapësirave dhe si formësojnë jetën publike dhe ate private.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> Të ofrojë studentëve qasje kritike në problematizimin e hapësirës si çështje e fuqisë, kulturës dhe politikës;

	<ul style="list-style-type: none"> Njohin pozicionet dhe debatet relevante në teoritë e hapësirës, fuqisë dhe reprezentimit; dhe Zhillojnë mendim kritik mbi dinamikat e prodhimit të hapësirës, analiza të marrëdhënieve të pushtetit dhe sistemeve simbolike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> Do të jenë në gjendje të njohim pozicionet e ndryshme në debatin akademik rreth hapësirës, fuqisë dhe reprezentimit; Do të mund demonstrojnë një vetëdije kritike të natyrës së shpjegimeve ndryshme rreth praktikave të prodhimit të hapësirës si medium shoqëror; dhe Të aplikojnë perspektivat e ofruara në studimet e aktitekturës.
Metodat e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies është e bazuar në ligjërata, ushtrime dhe punë praktike. Çdo student ka për obligim që të përgatisë dy detyra të shtëpisë. Mësimdhënësja shpjegon objektivat e mësimi studentëve përmes ligjëratave, përmes tabelës, projektorit dhe formave tjera vizuale prezantohen teoritë dhe konceptet kryesore. Mësimi i kombinuar interaktiv do të përdoret. Poashtu në lëndë do të zhvillohen diskutime and prezantime grupore nga studentët.
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja 10%; Vlerësimi i pare 10%; Vlerësimi i dytë 10%; Seminari 20%; Provimi final 50%; Total (përqindja mesatare) 100%.
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> Bachelard, Gaston. 1958. The Poetics of Space: The Classic Look how we Experience Intimate Spaces, Translation by Orion Press, 1964. Boston, Massachusetts: Beacon Press. Foucault, Michel. 1977. Power/Knowledge. New York: Pantheon Books. Foucault, Michel. 1977. Discipline and Punish: The Birth of the Prison. New York: Pantheon. Harvey, David. 2012. Rebel Cities: From the Right to the City to the Urban Revolution, London: Verso. Lefebvre, Henri. 1992. Rhythmanalysis: Space, Time and Everyday life. London and New York: Continuum. Todorova, M. 1997. Imagining the Balkans. Oxford: Oxford University Press. Weizman, Eyal. 2017. Forensic Architecture: Violence at the Threshold of Detectability
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> Agamben, Giorgio. 1998. Homo Sacer: Sovereign Power and Bare Life. CA: Stanford University Press. Heidegger, Martin. 1971. "Building, Dwelling, Thinking," from Poetry, Language, Thought, translated by Albert Hofstadter, New York: Harper Colophon Books. Weber, Max. The City, Translation and edited by Don Martindale and Gertrud Neuwirth 1966, New York: The Free Press.

Titulli i lëndës:	PROJEKTIM 5 – KOMPLEKSET INDUSTRIALE
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Arta Xhambazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6

Përshkrimi i lëndës:	Kursi Projektim 5: Komplekset Industriale diskuton dhe studion temën e projektimit të Industrisë - Komplekset Industriale. Kursi zhvillohet një herë në javë dhe është kurs i integruar me pjesëmarrje interaktive të studentëve. Roli kryesor i kursit është të studiojë dhe të hulumtojë tipologjinë e komplekseve industriale – struktura multifunksionale bashkëkohore, me theks në tipologjinë: Parqet industriale, industria ekstraktive, industria e rëndë, industria energjetike, industria e lehte prodhuese, kurse tipologjinë e strukturave multifunksionale do të caktohen për çdo vit akademik sipas trendeve aktuale në bashkëpunim me studentët dhe referencat ndërkombëtare akademike.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është të iniciojë, të përdorë parimet themelore teorike dhe praktike arkitekturore të projektimit, duke përfshirë ndërlidhjen simbiotike të avancimit të teknologjisë dhe projektimit arkitektonik. Objektivat kryesore të kursit janë subjekt i qasjeve të ndryshme ndërdisiplinore për të zgjidhur problemet e projektimit arkitektonik, zhvillimit ekonomik, duke ndarë proceset krijuese si një qasje për të identifikuar dhe zgjidhur varietetet e problemeve në Arkitekturë. urban, trafikut urban, mobilitetit, mirëqenjes publike dhe ndotjes së mjedisit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studentët duhet të kenë kuptuar dhe zotëruar parimet themelore projektuese të komplekseve multifunksionale - Komplekseve Industriale: <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë zhvilluar aftësitë dhe teknikat në projektim; - Studentët kanë zhvilluar aftësitë e nevojshme për projektim e komplekseve multifunksionale me fokus në Komplekset Industriale; - Studentët kanë zhvilluar aftësi dhe teknika për të përshkruar, analizuar dhe artikulluar procesin e projektimit ndërdisiplinor.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Kursi, Projektim 5, Komplekseve Industriale, promovon dhe inicon kuptuarjen e njohurive themelore, dhe të avancuara të projektimit arkitektonik. Tematika e shtjelluar në kurs korespondon, dhe aktualisht është në vijë me trendet bashkëkohore të mësimdhënjes në universitetet europiane dhe më gjërë. Studentët janë të pajisur me literaturën primare në gjuhën Shqipe falas, nga mësimdhënësi i kursit.
Metodat e mësimdhënies:	Mësimdhënia ka karakterin e diskutimeve interaktive, duke angazhuar në diskutim të gjithë studentët. Gjithashtu, kursi synon që studentët të marrë pjesë në punë në grup, dhe individuale, të cilët do të marrin detyra konkrete në formën e projekteve ideore arkitektonike. Ligjëratat, dhe ushtrimet gjatë mësimin në klasë përdorin mjete dhe teknika të ndryshme vizuale, kurse gjatë punës me studentë në konsultimet individuale promovohet dhe vlerësohet puna e pavarur në klasë, si dhe angazhimi dhe detyrat e shtëpisë.
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë për kursin: <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e studentit në ligjerata dhe ushtrime, aktiviteti ... 10% - Vlerësimi obligativ intermediar - Fazat 10% - Portfolio e punimeve grafike, detyrave, seminareve, të vlerësuar me notë - pozitive gjatë semestrit, janë kusht për të marrur ECTS – si dhe janë kusht

	<ul style="list-style-type: none"> - për t'iu nënshtruar provimit përfundimtar 50% - Provimi përfundimtar, Test me shkrim. 30%
Literatura primare:	<p>7. Bujar Bajçinovci, Industrial Complexes – Part 1, Planning and Design, in the Albanian Language, 4 (5), JOSHA, 2017. DOI: 10.17160/josha.4.5.348</p> <p>8. Bujar Bajçinovci, Industrial Complexes – Part 2, Planning and Design, in the Albanian Language, 4 (5), JOSHA, 2017. DOI: 10.17160/josha.4.5.349</p>
Literatura shitesë:	<p>10. Elena G. Popkova, Yulia V. Ragulin, Aleksei V. Bogoviz, Eds. Industry 4.0: Industrial Revolution of the 21st Century. (2019). Springer International Publishing AG</p> <p>11. Kwok G.A. et al. (2007). Environmental strategies for schematic design. Elsevier.</p>

Titulli i lëndës:	PROJEKTIM 6 - OBJEKTET ADMINISTRATIVE-AFARISTE
Mesimdhësi:	Prof.Asoc.Dr. Vlora Navakazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi përbëhet nga pjesa kryesore tematike, objektet administrative - afariste. Historiku i zhvillimit të objekteve administrative, definimi i hapësirave të posaçme (vendi i punës, bërthamat, llojet e konstrukcioneve të aplikueshme si dhe sallat për mbledhje).</p> <p>Do të prezantohet arkitektura bashkëkohore e ndërtesave administrative dhe afariste, duke analizuar karakteristikat e tipologjive dhe karakteristikave hapësinore, me orientimet dhe informatat themelore të nevojshme për të kuptuarit e procesit të projektimit të ndërtesave të kursit.</p>
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është njoftimi i studentëve për projektimin, organizimin hapësinor dhe teknologjinë e ndërtimit të objekteve të përfshirë në modulën e caktuar.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas realizimit të kursit studenti duhet të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njoh dhe të dalloj llojet e ndryshme të ndërtesave administrative dhe afariste; - Përcaktoj dhe njoh specifikat konstruktive, funksionale dhe hapësirore të ndërtesave; - Definoj dhe analizoj njësitë funksionale dhe hapësinore të ndërtesave administrative dhe afariste (biznesit); <ul style="list-style-type: none"> - Sintetizoj dhe demostroj njohuri dhe shkathtësi të nevojshme për projektimin ndërtesave;
Metodat e mësimdhënies:	Ligjeratat në mënyrën multimediale të komentimit analitik dhe krahasimit; ushtrimet e organizuara në grup për projekt, detyra individuale të mbuluara me korrigjime dhe konsultime.
Metodat e vlerësimit:	Me dorëzimin dhe vlerësimin pozitiv të punimit individual/grupor, studenti fiton të drejtën e nënshkrimit. Kriteret e vlerësimit dhe kalueshmërisë në :

	Prezenca në ligjerata dhe aktiviteti në ushtrime (10%), eseu (15%), Kolokiumi (15%); projekti Individual/grupor (2-3 studentë) (55%); Provimi përfundimtar (5%)
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Adler, D., METRIC HANDBOOK – Planning and Design Data (2nd edition), Architectural Press, OXFORD, 2000 2. Baiche, B. Walliman, N., Neufert-Architects' Data (third edition), Oxford, 2000 3.. Pevsner, N., A HISTORY OF BUILDING TYPES, Princeton University Press, 1976. 4. Duffy, F., Cave, C., Worthington, J., (editors), PLANNING OFFICE SPACE, The architectural press, London, 1977. 5. R.Hascher, S.Jeska, B.Klauck - A DESIGN MANUAL - OFFICE BUILDINGS 6. Përmbledhje e ligjeratave, “Objektet administrative-afariste”, Dr.sc.Vlora Navakazi
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. G. Knezevic, I. Kordis, “Stambene i Javne zgrade”, IRO Tehnicka knjiga, Zagreb, 1981. 2. A. Eugene Kohn, Katz, P. “Building Type Basics for Office Buildings (Building Type Basics Series)”, Neë York, 2002

Titulli i lëndës:	URBANIZMI 2
Mesimdhënesi:	Dr.Sc. Ilir Gjinolli
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Në kete studio, bërthama e aktiviteteve mësimore është puna në projekt te studentëve nën mbikëqyrjen e mesimdhënësve. Studentët, në bashkëpunim me mesimdhënësit, do të zgjedhin një qytet në Kosovë si lokacion të zhvillimit të projektit. Puna në projekt zhvillohet në grupe prej 4-6 studentëve e përkrahur nga mesimdhënësit dhe përkrahjet nga ligjërata, udhëheqja e mesimdhënësve dhe punëtoritë e veçanta.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është të aftësojë studentët në dizajnin urban. Përqendrimi do të jetë në planifikimin dhe zhvillimin një zone - komuniteti Lokal. Në fund të kursit kandidatët do të jenë aftësuar për pjesëmarrje efektive në procesin e hartimit të një plani rregullues urban për një zonë/lagje të qytetit
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrësit kanë zhvilluar aftësitë dhe teknikën e hulumtimit në dizajnin urban dhe format e ndryshme të komunikimit të dizajnit. • Pjesëmarrësit janë të gatshëm të aplikojnë në metodat dhe teknikën e përshtatshme të dizajnit urban. • Pjesëmarrësit kanë njohuri kontekstin institucional brenda të cilit zhvillohet procesi i planifikimit • Pjesëmarrësit kanë fituar njohuri të nevojshme dizajnin urban të një lagjeje/zone

Metodat e mësimdhënies:	Puna praktike në projekt e përkrahur me ligjërata dhe diskutime dhe udhëheqja nga mësimdhënësit. Metoda pedagogjike e aplikuar do të jetë mësimi i bazuar në problem dhe i orientuar kah veprimi – projekti
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Projekti 70% • Provimi final 30%
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> • Urban Design Compendium, Urban Design Alliance&Leëlin Davis, London 2003 • Responsive Environments, Sue Mc Glynn, Graham Smith, Alan Alcock, Paul Murrain, Ian Bentley, Architectural Press, London 2008 • Simon Bell: Elements of visual design, SPON Press, Third Edition, London 1993 • Urban Design Associates: The Urban Design Handbook, The techniques and Working Methods, W.W. Noton & Company, 2003
Literatura shitesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Ron Kasprisin: Urban Design Composition of complexity, Rutledge, London 2011, • Mike Biddulph: Introduction to Residential Layout, Architectural Press, 2007

Titulli i lëndës:	STRUKTURAT INXHINIERIKE
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Florim Grajcevc
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës	Historia e formimit të strukturave nga materialet e ndryshme. Qasje në standardet e Strukturave. Kërkesat e Eurokodeve për Strukturat. Analiza e veprimeve të jashtme dhe llogaria e elementeve të veçanta të strukturave nga betoni i armuar, druri monolit, druri i lameluar si dhe çeliku.
Qëllimet e lëndës:	Një modul teorik që aftëson studentin me njohurit e përgjithshme dhe të veçanta të strukturave, materialet e strukturave, llojet e strukturave dhe veçoritë e tyre. Njohja me elemente strukturore sisteme të ndryshme statike nga materialet e ndryshme. Studenti përgatitet që të llogarisë elemente të veçanta të strukturave nga betoni i armuar, druri dhe çeliku.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Shpjegon klasifikimin e Standardeve për Strukturat. Përshkruan kuptimin e gjendjes kufitare të Strukturave. Radhit dhe shpjegon llojet e betoneve për formimin e elementeve të konstruksioneve, rezistencat e betonit, klasat e betonit, modulet e elasticitetit të betonit, llojet e armaturës për betonin e armuar. Llogarit elemente të veçanta të konstruksioneve nga betoni i armuar. Përshkruan, vizaton dhe shpjegon llojet e elementeve të veçanta të konstruksioneve nga druri. Llogarit elemente e veçanta të konstruksioneve nga druri. Përshkruan, vizaton dhe shpjegon llojet e elementeve të veçanta të konstruksioneve nga çeliku.

Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Arkitektët të cilët merren me projektim të objekteve, ndërtim, menaxhim në ndërtim, verifikim të stabilitetit të objekteve, ju nevojiten njohuri dhe kompetenca nga fushat e Strukturave. Aktualiteti i lëndës për Strukturat është gjithmonë dhe i pa përgjithshëm për Objektet e të gjitha llojeve dhe pjesë përbërëse e Stabilitetit, qëndrueshmërisë dhe shfrytëzimit të tyre.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat me prezantim dhe demonstrime praktike të elementeve, të materialeve për konstruksionet e drurit monolit. Ushtrimet numerike. Seminar semestral me detyra konkrete. Diskutime gjatë ligjëratave. Ushtrime në grupe.
Metodat e vlerësimit:	Gjatë semestrit mbahen tri kolokiume me këto vlerësime: <ul style="list-style-type: none"> - kolokiumi i parë 10%, kolokiumi i dytë 10%. kolokiumi i tretë 10%. detyra shtepie 5%. Projekti 20%. provimi 40%
Literatura	
Literatura bazë:	Ligjëratat e mbajtura në formë elektronike
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Eurocode 0, Eurocode 1; Eurocode 2 - Design Aids for Eurocode 2 (part 1 ENV 1992-1-1). - R.S. Naraynan & A. Beeby, “Design Guide to EN 1992-1-1 & EN 1992-1-2”. Eurocode 2, Design of Concrete Structures, Bodmin G.B. 2005, - Tomicic, “Betonske Konstrukcije”, trece izmenjeno i dopunjeno izdanje,

Titulli i lëndës:	TEORIA DHE KRITICIZMI NË ARKITEKTURË
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Florina Jerliu
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Lënda shtjellon nocionet themelore, përbërësit dhe parimet bazë të arkitekturës prej Vitruvit deri sot. Në këtë kuadër, studentët do të njihen me trajtesat teorike dhe kritike në lidhje me estetikën, pushtetin, evolucioni dialektik në arkitekturë, gjenezën e arkitekturës (Initium Topos), utopinë, traditën dogmatike dhe thyerjen e saj, përkufizimet rreth stilit dhe shijes së lartë në arkitekturë, për të arritur te konceptet dhe konteksti i dilemave të arkitekturës në kohët recente të modernitetit dhe postmodernës.
Qëllimet e lëndës:	Hulumtimi i ideve të cilat qëndrojnë prapa pamjes së ndërtesave, e që në fakt është teoria e arkitekturës; Të kuptuarit e polaritetit midis njohurive specialiste dhe vazhdimësisë së njohurve të njerëzimit; Teoria dhe praktika janë të pandara, prandaj synohet qasja kritike ndaj të krijuarit si rrjedhojë e konventave tradicionale, koncepteve eksperimentale dhe gjykimeve estetike, e që ndihmon në formësimin e gjykimit teorik dhe kritik të studentit të arkitekturës.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: aftësohet në interpretimin e bazës teorike të arkitekturës, traktateve dhe qëndrimeve kritike nga arkitektët dhe teoricienët e arkitekturës; <ul style="list-style-type: none"> – krijojë kuadrin e gjykimit kritik ndaj idesë, koncepteve themelore dhe prodhimit arkitektonik në kontekst,

	– zhvillojë shkathtëstë në artikulum, referencim teorik dhe shkrim akademik
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata interaktive, diskutimeve, detyrë shtëpie individuale dhe grupore, prezantime të punës së studentëve.
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyrat seminarike dhe prezantimet e studentëve 60%, Vlerësimi nga testet 15% ose Provimi final 30%
Literatura primare:	F.Jerliu (2005) Dispencë: Teoria dhe Kriticizmi në Arkitekturë, UP/WUS Ch. Jencs , K.Kropf (2006)Theories and manifestoes of contemporary architecture, second edition, Academy Press Hanno-Walter Kruft (1996) History of Architectural Theory, from Vitruvius to the present , 1 edition, Princeton Architectural Press Vitruvius (1960) The Ten Books on Architecture, Dover Publications: Obligative kaptinat: a) Libri 2/K1, b) Libri 3/K1, c) Libri 4K1 Alberti (1991) On the art of building in Ten Books / De re aedificatoria/ - Obligative kaptinat: a) Libri 6/K4, b) Libri 9/K1 Marc-Antoine Laugier (W. H. and A. H., 2009). An essay on architecture - Obligative kaptina: K1 Mari Hvattum(2004) Gottfried Semper and the Problem of Historicism, Cambridge University Press (obligative: The Cult of Origins, ff 29-35) Revista e lëndës “ARKITEKTURA – Diskurs Teorik” numrat 1,2,3
Literatura shitesë:	K. Michael Hays (Ed.) (200) Architecture Theory since 1968, The MIT Press Andrea Palladio, R.S. , R. T. Transl. (2002) The four books on architecture, The MIT Press Hilde Heynen (2000) Architecture and modernity, A Critique, The MIT Press; Revised edition Joseph Rykwert (1981) On Adam’s House in Paradise, The MIT Press; 2nd edition EAAE Prize 2003-2005, Writing in Architectural Education: http://www.archdesign.vt.edu/news/pdf/eaee-prize-2003-05-essays.pdf